



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJANE
MUNICIPALITY OF LIPJAN



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



**Accessible
Quality
Healthcare**

Kapiteti Shëndetësor i Qashtëm dhe Cilësor
Prisypaçia i Kvalitetit Zërvatësues Çështës

Pranuar më:
Primljeno: 20.07 2023

SDC project implemented by Swiss TPH

Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
07-020/01	-	37337

Memorandum of Understanding

Memorandum Mirëkuptimi

between

ndërmjet

MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMUNA E LIPJANIT

represented by Mr. Imri Ahmeti

përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti

AND

DHE

**ACCESSIBLE QUALITY HEALTH CARE
PROJECT (AQH)**

**PROJEKTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR TË
QASSHËM DHE CILËSOR (AQH)**

represented by Mr. Nicu Fota

përfaqësuar nga z. Nicu Fota

Background

Sfondi

This Memorandum of Understanding (hereinafter referred to as the 'Memorandum') aims to establish a partnership between the Accessible Quality Health Care Project AQH (hereinafter referred to as 'AQH') and the Municipality of Lipjan (hereinafter referred to as 'Municipality').

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejshëm i referuar si 'Memorandumi') synon të krijojë një partneritet ndërmjet Projektit të Kujdesit shëndetësor të qashtëm dhe cilësor AQH (në tekstin e mëtejshëm 'AQH') dhe Komunës së Lipjanit (në tekstin e mëtejshëm 'Komuna').

This document presents an agreement that legally binds the parties in the implementation of various activities for common goals and elaborates the conditions under which this cooperation will function as well as the roles and responsibilities of each party.

Ky dokument paraqet një marrëveshje që lidh ligjërisht palët në zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për qëllime të përbashkëta dhe elaboron kushtet në të cilat do të funksionojë ky bashkëpunim si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

Article 1 Purpose

Neni 1 Qëllimi

The purpose of this Memorandum is to co-finance the renovation of the yard, parking lot and facade of the Family Medicine Center Gadime (hereinafter referred to as 'FMC Gadime') and renovation of the infrastructure of the Family Medicine Center Janjeve (hereinafter referred to as 'FMC Janjeve') for the provision of better-quality health services to the community it serves, including to the vulnerable groups, and for strengthening the Municipality Primary Healthcare management capacities to promote good practices within the forum of other municipalities.

Qëllimi i këtij Memorandumi është të bashkëfinancojë rinovimin e oborrit, parkingut dhe fasades së Qendrës së Mjekësisë Familjare Gadime (në tekstin e mëtejshëm 'QMF Gadime') dhe rinovimin e infrastrukturës së Qendrës së Mjekësisë Familjare Janjevë (në tekstin e mëtejshëm 'QMF Janjevë') për ofrimin e shërbimeve shëndetësore më cilësore për komunitetin të cilit i shërben, duke përfshirë grupet e cenueshme, dhe për forcimin e kapaciteteve menaxhuese të Shëndetësisë Parësore të Komunës për promovimin e praktikave të mira në forumin e komunave tjera.

The parties, Municipality and AQH, understand to

Palët, Komuna dhe AQH, kuptojnë të promovojnë

promote good governance through participation and transparency in planning and decision-making towards a smooth fulfilment of the present Memorandum objectives.

Article 2 Obligations of the Municipality

1. Through this Memorandum, the Municipality commits to participate and to co-finance the infrastructure rehabilitation of FMC Janjeve with the necessary funds in amount of up to 47.599,90 Euros (fifty-seven thousand five hundred ninety-nine Euros and eighty cents)
2. The amount mentioned at para.1 of this article will be allocated from the Municipality of Lipjan budget, the economic category "fund for co-financing with donors".
3. The municipality commits to appoint the contact person responsible for the implementation of the present MoU, who will cooperate and communicate with AQH.
4. All necessary consents / permits for the works regarding the renovation of the FMC Janjeve and FMC in Gadime, as well as the designation of a landfill, should be provided by the Municipality of Lipjan.

Article 3 Obligations of the AQH

1. Through this Memorandum, AQH undertakes to participate and to co-finance the renovation of the yard, parking lot and facade of FMC Gadime in amount of up to 49.825,76 Euros (forty-nine thousand eight hundred twenty-five euros and seventy-six cents).
2. Through its procurement department, AQH will call for applications, select the executing company, contract and monitor the execution of the renovation works in accordance with the Swiss and international procurement standards and in cooperation with the Municipality.
3. Through its procurement department, and based on the needs assessment performed, AQH will elaborate the terms of references for the

qeverisjen e mirë nëpërmjet pjesëmarrjes dhe transparencës në planifikim dhe vendimmarrje drejt një përbushjeje pa probleme të objektivave të Memorandumit aktual.

Neni 2 Detyrimet e Komunës

1. Përmes këtij Memorandumi, Komuna zotohet të marrë pjesë dhe të bashkëfinancojë rehabilitimin e infrastrukturës së QMF Janjeve me fondet e domosdoshme deri në 47.599,90 Euro (dyzet e shtatë e mijë e pesë qind e nëntëdhjetë Euro dhe nëntëdhjetë e cent).
2. Shuma e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të ndahet nga buxheti i Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike "kodi për bashkëfinancim me donatorë".
3. Komuna angazhohet të caktojë personin kontaktues përgjegjës për zbatimin e këtij MM, i cili do të bashkëpunojë dhe komunikojë me AQH-në.
4. Të gjitha pëlqimet/lejet e nevojshme për punimet lidhur me renovimin e QMF Janjeve dhe QMF Gadime, si dhe caktimin e deponisë, duhet të sigurohen nga Komuna e Lipjanit.

Neni 3 Detyrimet e AQH

1. Nëpërmjet këtij Memorandumi, AQH merr përsipër të marrë pjesë dhe të bashkëfinancojë rinovimin e oborrit, parkingut dhe fasaden e QMF Gadime në vlerë prej deri në 49.825,76 Euro (dyzet e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e pesë Euro e shtatëdhjetë e gjashtë cent).
2. Nëpërmjet departamentit të saj të prokurimit, AQH do të bëjë thirrje për aplikime, do të përzgjedhë kompaninë zbatuese, do të kontrakttojë dhe do të monitorojë kryerjen e punimeve të rinovimit në përputhje me standardet zvicerane dhe ndërkombëtare të prokurimit dhe në bashkëpunim me Komunën.
3. Nëpërmjet departamentit të saj të prokurimit, dhe bazuar në vlerësimin e nevojave të kryera, AQH do të elaborojë termat e referencës për punimet e

1. The Memorandum enters into force on the day of signing by the parties.
2. This Memorandum is drafted in two (2) identical originals and each of the parties receives one (1) copy.

Signed, date.....

18/07/2023

**Accessible Quality
Healthcare Project
AQH**

Name: Nicu Fota
Title: Team Leader
Address: Tirana Str
10000 Prishtina

Municipality of Lipjan

Name: Imri Ahmeti
Title: Municipal Mayor
Address: Str. Shqiperia
nr.28

14000 Lipjan



3. Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.
4. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje origjinale identike dhe secila nga palët merr nga një (1) kopje.

Nënshkruar me datë.....

**Projekti i Kujdesit
Shëndetësor të qashtëm
dhe cilësor AQH**

Emri: Nicu Fota
Titulli: Drejtues ekipi
Adresa: Rr. Tirana
10000 Prishtinë

Komuna e Lipjanit

Emri: Imri Ahmeti
Titulli: Kryetar i
Komunës
Adresa: Rr. Shqipëria
nr.28

14000 Lipjan





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJANE
MUNICIPALITY OF LIPJAN



Accessible
Quality
Healthcare
Federal Government | Swiss State Office
Prilidhjet e Kulturës Shëndetësore

SDC project implemented by Swiss TPH

Memorandum of Understanding

between

MUNICIPALITY OF LIPJAN

represented by Mr. Imri Ahmeti

AND

ACCESSIBLE QUALITY HEALTH CARE
PROJECT (AQH)

represented by Mr. Nicu Fota

Memorandum Mirëkuptimi

ndërmjet

KOMUNA E LIPJANIT

përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti

DHE

PROJEKTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR TË
QASSHËM DHE CILËSOR (AQH)

përfaqësuar nga z. Nicu Fota

Background

This Memorandum of Understanding (hereinafter referred to as the 'Memorandum') aims to establish a partnership between the Accessible Quality Health Care Project AQH (hereinafter referred to as 'AQH') and the Municipality of Lipjan (hereinafter referred to as 'Municipality').

This document presents an agreement that legally binds the parties in the implementation of various activities for common goals and elaborates the conditions under which this cooperation will function as well as the roles and responsibilities of each party.

Article 1 Purpose

The purpose of this Memorandum is to co-finance the renovation of the Family Medicine Center Gadime (hereinafter referred to as 'FMC Gadime') for the provision of better-quality health services to the community it serves, including to the vulnerable groups, and for strengthening the Municipality Primary Healthcare management capacities to promote good practices within the forum of other municipalities.

The parties, Municipality and AQH, understand to promote good governance through participation and transparency in planning and decision-making towards a smooth fulfilment of the present Memorandum

Sfondi

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejme i referuar si 'Memorandumi') synon të krijojë një partneritet ndërmjet Projektit të Kujdesit shëndetësor të qasshëm dhe cilësor AQH (në tekstin e mëtejme 'AQH') dhe Komunës së Lipjanit (në tekstin e mëtejme 'Komuna').

Ky dokument paraqet një marrëveshje që lidh ligjërisht palët në zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për qëllime të përbashkëta dhe elaboron kushtet në të cilat do të funksionojë ky bashkëpunim si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është të bashkëfinancojë rinovimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare Gadime (në tekstin e mëtejme 'QMF Gadime') për ofrimin e shërbimeve shëndetësore më cilësore për komunitetin të cilit i shërben, duke përfshirë grupet e cënueshme, dhe për forcimin e kapaciteteve menaxhuese të Shëndetësisë Parësore të Komunës për promovimin e praktikave të mira në forumin e komunave tjera.

Palët, Komuna dhe AQH, kuptojnë të promovojnë qeverisjen e mirë nëpërmjet pjesëmarrjes dhe transparencës në planifikim dhe vendimmarrje drejt një përmbushjeje pa probleme të objektivave të

objectives.

Article 2 Obligations of the Municipality

1. Through this Memorandum, the Municipality commits to participate and to co-finance the infrastructure rehabilitation of FMC Gadime in amount of 63,000 Euros (sixty-three thousand Euros).
2. The amount mentioned at para.1 of this article will be allocated from the Municipality of Lipjan budget, the economic category "fund for co-financing with donors".
3. The municipality commits to appoint the contact person responsible for the implementation of the present MoU, who will cooperate and communicate with AQH.
4. All necessary consents / permits for the works regarding the renovation of the FMC in Gadime, as well as the designation of a landfill, should be provided by the Municipality of Lipjan.

Article 3 Obligations of the AQH

1. Through this Memorandum, AQH undertakes to participate and to co-finance the infrastructure rehabilitation of FMC Gadime with the necessary funds in amount of up to 100,000 Euros (one hundred thousand Euros).
2. Through its procurement department, AQH will call for applications, select the executing company, contract and monitor the execution of the renovation works in accordance with the Swiss and international procurement standards and in cooperation with the Municipality.
3. Through its procurement department, and based on the needs assessment performed, AQH will elaborate the terms of references for the necessary renovation works, in cooperation with the Municipality.
4. AQH commits to appoint the contact person responsible for the implementation of the present MoU, who will cooperate and communicate with Municipality.

Article 4

Memorandumit aktual.

Neni 2 Detyrimet e Komunës

1. Përmes këtij Memorandumi, Komuna zotohet të marrë pjesë dhe të bashkëfinancojë rehabilitimin e infrastrukturës së QMF Gadime në vlerë prej 63,000 Euro (gjashtëdhjetë e tre mijë Euro).
2. Shuma e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të ndahet nga buxheti i Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike "kodi për bashkëfinancim me donatorë".
3. Komuna angazhohet të caktojë personin kontaktues përgjegjës për zbatimin e këtij MM, i cili do të bashkëpunojë dhe komunikojë me AQH-në.
4. Të gjitha pëlqimet/lejet e nevojshme për punimet lidhur me renovimin e QMF Gadime, si dhe caktimin e deponisë, duhet të sigurohen nga Komuna e Lipjanit.

Neni 3 Detyrimet e AQH

1. Nëpërmjet këtij Memorandumi, AQH merr përsipër të marrë pjesë dhe të bashkëfinancojë rehabilitimin e infrastrukturës së QMF Gadime me fondet e domosdoshme deri në 100,000 Euro (njëqind mijë Euro).
2. Nëpërmjet departamentit të saj të prokurimit, AQH do të bëjë thirrje për aplikime, do të përzgjedhë kompaninë zbatuese, do të kontrakttojë dhe do të monitorojë kryerjen e punimeve të rinovimit në përputhje me standardet zvicerane dhe ndërkombëtare të prokurimit dhe në bashkëpunim me Komunën.
3. Nëpërmjet departamentit të saj të prokurimit, dhe bazuar në vlerësimin e nevojave të kryera, AQH do të elaborojë termat e referencës për punimet e nevojshme të rinovimit, në bashkëpunim me Komunën.
4. AQH zotohet të caktojë personin kontaktues përgjegjës për zbatimin e këtij MM, i cili do të bashkëpunojë dhe komunikojë me Komunën.

Contracting and execution of infrastructure rehabilitation works

1. The parties, AQH and Municipality, will take part in contracting arrangements with the executing company.
2. The payment to the executing company will be done in tranches in accordance with the payment procedures stipulated in the contract of the executing company, and only after the confirmation of the intermediary and final stages of infrastructure rehabilitation works achievement as per the quality and volume of work required by the contract of the executing company.

Article 5 Change and termination

1. This Memorandum may be amended by the parties only in writing.
2. This Memorandum may be terminated by either party provided it notifies the other party in writing 60 (sixty) days in advance.

Article 6 Dispute resolution

1. The Parties shall endeavor to settle in the most appropriate manner any dispute arising out of this Memorandum of Understanding.

Article 7 Entry into force

1. The Memorandum enters into force on the day of signing by the parties.
2. This Memorandum is drafted in two (2) identical originals and each of the parties receives one (1) copy.

Neni 4 Kontraktimi dhe kryerja e punimeve të rehabilitimit të infrastrukturës

3. Palët, AQH dhe Komuna, do të marrin pjesë në marrëveshjet kontraktuese me kompaninë punëkryese.
4. Pagesa për kompaninë me kompaninë punëkryese do të bëhet në këste në përputhje me procedurat e pagesës të përcaktuara në kontratën e kompanisë punëkryese dhe vetëm pas konfirmimit të fazave ndërmjetëse dhe përfundimtare të punimeve të rehabilitimit të infrastrukturës sipas cilësisë dhe vëllimit të punës të kërkuar me kontratën e kompanisë punëkryese.

Neni 5 Ndryshimi dhe ndërprerja

3. Ky Memorandum mund të ndryshohet nga palët vetëm me shkrim.
4. Ky memorandum mund të ndërpritet nga secila palë me kusht që të njoftojë palën tjetër me shkrim 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.

Neni 6 Zgjidhjen e kontesteve

2. Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që lind nga ky Memorandum Mirëkuptimi.

Neni 7 Hyrja në fuqi

3. Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.
4. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje origjinale identike dhe secila nga palët merr nga një (1) kopje.

Signed today,date

Nënshkruar sot,datë

**Accessible Quality
Healthcare Project
AQH**

Name: Nicu Fota
Title: Team Leader
Address: Tirana Str
10000 Prishtina



SWISS TPH
INGO 5300563-2
KOSOVO

Municipality of Lipjan

Name: Imri Ahmeti
Title: Municipal Mayor
Address: Str.Shqiperia
nr.28
14000 Lipjan



**Projekti i Kujdesit
Shëndetësor të qasshëm
dhe cilësor AQH**

Emri: Nicu Fota
Titulli: Drejtues ekipi
Adresa: Rr. Tirana
10000 Prishtinë



SWISS TPH
INGO 5300563-2
KOSOVO

Komuna e Lipjanit

Emri: Imri Ahmeti
Titulli: Kryetar i
Komunës
Adresa: Rr. Shqipëria
nr.28
14000 Lipjan





REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E LIPLJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno: 17. 10 2023		
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
01-660/03-59627		



KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALIT OF LIPLJAN

Memorandumi i Bashkëpunimit
në mes
OJQ – Advancing Together (AT)
dhe
Komunës së Lipjanit

OJQ "Advancing Together, me adresë në Rr. "Rexhep Mala", Nr. 36, Prishtinë, Kosovë.
Komuna e Lipjanit, me adresë në Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi në mes të subjekteve të lartcekura në zbatimin e Projektit "Bëhu Partneri Im për Mirëqenie – faza 2" 2023/2024 të financuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë-UNMIK, për fuqizimin e komuniteteve lokale, duke kontribuar kështu në hartimin, zbatimin, dhe monitorimin e planeve dhe projekteve në lidhje me komunitetet.

Neni 2

Arsyeshmëria

Duke pasur parasysh që autoritetet lokale kanë rolin vendimtar në zhvillimin dhe përmirësimin e jetesës së komuniteteve në fushat prioritare - arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, strehimi, promovimi kulturor, të rinjtë dhe gratë, buxhetimi i përgjegjshëm, përkrahja për personat e kthyer dhe të zhvendosur brenda vendit, ndërtimi i besimit dhe bashkëpunimit në mes komuniteteve - në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse, kornizën ligjore dhe dokumentet strategjike.

Neni 3

Fushat e Bashkëpunimit

Palët e lartcekura do të bashkëpunojnë ngushtë në përmirësimin dhe promovimin e qeverisjes lokale demokratike, si dhe forcimin e komunikimit dhe koordinimit funksional ndërmjet komuniteteve jo shumicë dhe autoriteteve të nivelit lokal dhe qendror.

Fuqizimi i kapaciteteve lokale përmes zhvillimit dhe zbatimit të projekteve të vogla, të cilat bazohen në prioritetet e anëtarëve të komunitetit jo-shumicë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nivel lokal. Këto projekte ofrojnë një nxitje për anëtarët e komuniteteve jo-shumicë dhe autoritetet lokale që bashkërisht dhe në mënyrë efektive të angazhohen në mekanizmat lokalë. Marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në komunë do të përmirësohen dhe do të vendosen lidhje më të ngushta me mekanizmat komunalë.

Forcimi i kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, për të përforcuar mekanizmat komunale. Rritja e njohurive dhe kuptimit, të funksionimit të strukturave dhe mjeteve në dispozicion, do të përmirësojë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet komunës dhe komuniteteve jo shumicë, si dhe ndërmjet komunës dhe strukturave të nivelit qendror.

Neni 4

Specifika e bashkëpunimit

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit pajtohen si në vijim:

- Do të angazhohen për rritjen e bashkëpunimit, mekanizmat e komunikimit të rregullt, shkëmbimin e informacionit dhe përditësimin e aktiviteteve përkatëse;
- Do të dakordohen për themelimin e 'Forumit Ndërkomunitar' pjesë e cilës do të jenë autoritetet lokale dhe përfaqësues të komuniteteve (duke siguruar pjesëmarrjen e grave dhe të rinjëve) dhe do të organizojnë dhe marrin pjesë në takime të Forumit për të identifikuar nevojat e tyre prioritare për projekte të komunitetit;
- Do të marrin pjesë çdo tre muaj në takimet e 'Komitetit Shqyrtues të Projekteve' për të monitoruar progresin e realizimit të projekteve, për të komunikuar rezultatet e projektit, për të mbikëqyrë dhe mbështet projektet në mënyrë që të sigurohet arritja e qëllimeve.
- Do të shqyrtojnë mundësitë e bashkëfinancimit të projekteve prioritare dhe me interes, për komunitetet pakicë.

4.1. Përgjegjësitë e AT -së në këtë Memorandum Bashkëpunimi:

- Do të fuqizoj mekanizmat institucional për adresimin e nevojave dhe çështjeve që lidhen me komunitetet;
- Do të përmirësoj dhe zgjeroj angazhimin, kapacitetet, njohuritë dhe aftësitë e institucioneve për të punuar për përfshirjen e komuniteteve, duke vënë në praktikë konceptet e qeverisjes së mirë dhe duke rritur bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve dhe komuniteteve;
- Mbështetje komunave dhe komuniteteve për të zbatuar masat e hartuara dhe projektet e përzgjedhura së bashku;
- Organizimi i punëtorive për ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal;
- Do të siguroj koordinimin dhe administrimin e përgjithshëm të Projektit.

4.2. Përgjegjësitë e Komunës në këtë Memorandum Bashkëpunimi:

- Do të caktoj një person, me autoritet vendimmarrës, që do të jetë përgjegjës për procesin në lidhje me pjesëmarrjen dhe zbatimin e Projektit;
- Do të merr pjesë në takimet e Forumit Ndërkomunitar, në punëtoritë për ngritje të kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe përfaqësuesve të komuniteteve;
- Do të mbështes zbatimin e ndryshimeve pozitive në praktikën aktuale administrative që mund të identifikohen si rezultat i trajnimit, përmes punëtorive dhe dialogut të strukturuar me komunitetet;
- Do të siguroj pjesëmarrjen e stafit të departamenteve komunale të interesuara në aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të planifikuara në kuadër të Projektit të AT-së;
- Do të siguroj pjesëmarrje të plotë dhe bashkërendim të stafit përkatës administrativ dhe departamenteve komunale gjatë zbatimit të projekteve që do të financohen nga AT, përfshirë raportimin narrativ dhe financiar si dhe monitorimin.

Neni 5

Kohëzgjatja

Ky Memorandum Bashkëpunimi është i vlefshëm nga data e nënshkrimit dhe ka efekte juridike deri më 15 qeshor 2024.

Neni 6

Ndërprerja

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndërpritet:

- Në çdo kohë në rast të mos respektimit të pikave të marrëveshjes nga të dyja palët.
- Me paralajmërim me shkrim së paku 30 ditë para datës së ndërprerjes së marrëveshjes.

Neni 7

Ndryshimi dhe Amendamenti

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të rishikohet, ndryshohet dhe plotësohet në bazë të pajtimit paraprak ndërmjet palëve nënshkruese. Palët do të përpiqen që të zgjidhin të gjitha mospajtimet që mund të dalin nga ky memorandum në bazë të partneritetit dhe mirëkuptimit të dyanshëm përfshirë dhe ndërmjetësimin.

Neni 8

Gjuha dhe Kopjet e Memorandumit

Ky Memorandum Bashkëpunimi në pajtim të palëve është përpiluar në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në dy kopje të njëjta, nga një kopje për secilën palë.


Neni 9

Hyrja në Fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hynë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Palët:


AT
Drejtori Ekzekutiv



Z. Bashkim Ibishi
Data:



Komuna e Lipjanit
Kryetari i Komunës



Z. Imri Ahmeti
Data:





KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar më: Prilajeno: 16.11.2023		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/01-64369		

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes të palëve

Komuna e Lipjanit

dhe

OJQ Centre for Education and Development of Environment (CEDE)

Nëntor 2023



Ky Memorandum Bashkëpunimi përcakton termat e bashkëpunimit në mes të Komunës së Lipjanit dhe Centre for Education and Development of Environment (CEDE) për bashkëpunimin e tyre në zbatimin e aktiviteteve të cilat kanë për qëllim mirëqenien e komunitetit të fshatit Magure.

1. Sfondi

Përmirësimi i jetës dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit është një prej shtyllave kryesore të qeverisjes së Komunës. Në këtë kontekst, duke marrë në konsideratë ekzistencën e Qendrës së Azilit në Magure, Komuna ka fokus të veçantë në përmirësimin e gjendjes së komuniteteve në këtë fshat. Në anën tjetër, CEDE dhe FIQ janë duke zbatuar projektin “Përmirësimi i mirëqenies së azilkërkuesve, nxitja e shkëmbimit kulturor dhe integritit midis azilkërkuesve dhe komunitetit lokal” të financuar nga Sekretariati Shtetëror (Zvicëran) për Migracion - SEM. Gjatë përgatitjes së projektit, janë marrë në konsideratë nevojat e azilkërkuesve, komunitetit lokal si dhe incidentet që kanë ndodhur në të kaluarën. Për të kontribuar në arritjen e sukseseve të përbashkëta në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, nëpërmjet këtij Memorandumi, është e rëndësishme dhe nevojshme të krijohen mundësi bashkëpunimi dhe koordinimi të dyanshëm në zbatimin e aktiviteteve të projektit në fjalë.

2. Qëllimi

Ky Memorandum ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit në mes të palëve, ofrimin e ndihmës reciproke dhe bashkërendimin e aktiviteteve në kuadër të projektit “Përmirësimi i mirëqenies së azilkërkuesve, nxitja e shkëmbimit kulturor dhe integritit midis azilkërkuesve dhe komunitetit lokal” të cilin e zbaton OJQ CEDE dhe FIQ. Disa prej aktiviteteve të këtij projekti përfshijnë **a)** vendosjen e kamerave të sigurisë përgjatë rrugëve kryesore të fshatit Magure; **b)** rregullimi i një hapësire në zonën e Magures (park lojrash) dhe **c)** promovim i integritit social përmes aktiviteteve të përbashkëta sociale dhe sportive (turnir sportiv dhe pastrim i hapësirave publike nga mbeturinat).

3. Obligimet e Komunës së Lipjanit

Komuna e Lipjanit, sipas kompetencës dhe mundësive të bashkëpunimit të saj:

- a) Ofron mbështetjen dhe bashkëpunimin me organizatën në aktivitetet e përmendura më sipër;
- b) Formon një grup punues për të udhëhequr procesin e vendosjes së kamerave, përcaktimit të hapësirës publike për rregullim (kënd lojërash) dhe për pastrim të hapësirave publike në Magure; Grupi punues themelohet me Vendim të Kryetarit të Komunës pas hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Grupi punues udhëhiqet nga Koordinatori i Grupit punues i cili njëkohësisht do të jetë edhe person kontaktues për koordinim të aktiviteteve në kuadër të këtij



projekti. Përbërja e grupit punues, detyrat dhe përgjegjësitë do të përcaktohen më detajisht në vendimin për themelimin e grupit punues.

- c) Komuna e Lipjanit gjatë realizimit të këtij projekti do të krijojë lehtësira administrative për OJQ CEDE, përkatësisht për të gjitha kërkesat që parashtrihen për realizimin e këtij projekti dhe të cilat u adresohen Organeve të Administratës Komunale do të ketë lirim nga pagesa e taksave komunale.

Lejon shfrytëzimin e infrastrukturës aktuale publike (psh. shtylla ndriçimi) për vendosjen e kamerave të sigurisë, sipas përcaktimit nga grupi punues.

- d) Ofron dhe lehtëson qasje në të dhëna relevante mbi projektet dhe aktivitetet e tij.

4. Obligimet e OJQ CEDE:

OJQ CEDE merr përsipër ta bëjë financimin e këtij Projekti në vlerë prej 45,000.00 € (katërdhjetë e pesë mijë euro) për aktivitetet si vijon:

- Financon dhe mbështetë të gjitha aktivitetet lidhur me procesin e vendosjes së, deri në 30 kamera të sigurisë, në zonën e fshatit Magure ;
- Kujdeset që vendosja e kamerave të jetë në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale (privatësisë)
- Financon rregullimin e një hapësire publike (kënd lojërash) në zonën e Magures;
- Bënë organizimin e trajnimeve me komunitet sipas vlerësimit të nevojave nga grupi punues.
- Siguron ruajtjen e të dhënave dhe shfrytëzimin e tyre vetëm për nevojat e këtij projekti.

5. Financimi

Bashkëpunimi nëpërmjet këtij Memorandumi bëhet për të rritur angazhimin e përbashkët të palëve në funksion të përmirësimit të mirëqenies së komuniteteve në Magure dhe si i tillë nuk përfshinë zotim të fondeve apo implikime financiare nga Komuna e Lipjanit. OJQ CEDE është palë e cila zotohet për financim të aktiviteteve të sipërpërmendura.

6. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e kamerave pas përfundimit të Memorandumit të Mirëkuptimi

Pas përfundimit të Memorandumit të Mirëkuptimit kamerat do të menaxhohen nga Policia ndërsa do të regjistrohen si donacion në regjistrin e aseteve komunale. Deri në skadimit e afatit të garancionit të kamerave, në rast të defekteve të mundshme do të kujdeset Kompania nga e cila janë blerë këto pajisje ndërsa pas përfundimit të afatit të garancionit do të mirëmbahen nga Komuna.



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



7. Raportimi

Pas përfundimit të kohëzgjatjes së këtij Memorandumi, palët do të vlerësojnë performancën e këtij bashkëpunimi, sfidat dhe të arriturat e përbashkëta në kuadër të këtij projekti.

8. Kohëzgjatja

Ky Memorandum është me dëshirë dhe mund të modifikohet me pëlqimin reciprok të zyrtarëve të autorizuar nga Komuna dhe CEDE. Ky Memorandum hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga palët, dhe do të mbetet në fuqi derisa të modifikohet ose të përfundojë nga ndonjëri prej palëve me pëlqim reciprok. Në mungesë të marrëveshjes së ndërsjellë nga zyrtarët e autorizuar të palëve, ky memorandum do të përfundojë më 31/08/2024.

Lipjan, 15 nëntor 2023

IMRI AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit




v

ARBEN NIKA

Drejtore – Centre for Education and Development
of Environment (CEDE)



v



Pranuar me: Primijeno: 04.07.2023		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-330/01-34003		

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet



DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRIË KOSOVË
CHAMBER OF TRADE AND INDUSTRY KOSOVA

DHOMËS SË TREGTISË DHE INDUSTRIË KOSOVË

dhe



KOMUNËS SË LIPJANIT

Lipjan, 2023

A.S. V.P.

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

i nënshkruar më datë 04 Korrik 2023 në Lipjan, ndërmjet:

1. **Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë**, me adresë Bulevardi Bill Clinton, hyrja 270, nr. 6, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Nënkryetari i Bordit z. Arsim Selmonmusaj, nga njëra anë dhe
2. **Komunës së Lipjanit**, me adresë në Rr. Shqipëria, nr. 28, 14000 Lipjan, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Nënkryetari i Komunës z. Diamant Bytyqi, në anën tjetër.

Neni 1

Lënda dhe qëllimi

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (në tekstin e mëtejme Dhoma e Tregtisë) dhe Komuna e Lipjanit, përmes këtij Memorandumi të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, pajtohen që të krijojnë partneritet me qëllim të shkëmbimit dhe ofrimit të këshillave profesionale për bizneset në fusha të ndryshme, si dhe të asistimit, promovimit dhe përkrahjes së bizneseve anëtare të Dhomës së Tregtisë.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Ofrimin e këshillave profesionale në fusha të ndryshme, për bizneset anëtare të Dhomës së Tregtisë;
2. Dhoma e Tregtisë dhe Komuna e Lipjanit pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe të ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social;
3. Dhoma e Tregtisë dhe Komuna e Lipjanit pajtohen që të këmbëjnë informacione nga bazat e tyre të të dhënave lidhur me aktivitetet e tyre dhe të bizneseve anëtare (përveç të dhënave që konsiderohen sekrete afariste). Këmbimi i shënimeve duhet të bëhet në bazë të kërkesave të autorizuara të dy palëve;
4. Dhoma e Tregtisë dhe Komuna e Lipjanit pajtohen që në përgatitjen e propozimeve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, që kanë të bëjnë me përkrahjen e komunitetit të biznesit kosovar dhe në fusha tjera, të paraqesin oferta të përbashkëta dhe të këmbëjnë informatat e domosdoshme për implementimin e projekteve;

A.S. V.P.

5. Dhoma e Tregtisë dhe Komuna e Lipjanit, si ofrues të përbashkët të këtyre shërbimeve dhe nxitës për një ambient më të mirë ekonomik, pajtohen se do t'iu ofrojnë partneritet konstruktiv Institucioneve Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, në avancimin dhe ngritjen e standardeve drejt integritimit ekonomik të vendit me Bashkimin Evropian dhe organet relevante euro-atlantike;
6. Për shkëmbimin e përvojave dhe për të siguruar qasje sistematike ndaj problemeve të identifikuara gjatë punës së përbashkët;
7. Dhoma e Tregtisë dhe Komuna e Lipjanit pajtohen të organizojnë aktivitete të përbashkëta, si trajnime, seminare dhe aktivitete të tjera, me koordinim paraprak të të dyja palëve;
8. Këmbimi i përvojave dhe informatave profesionale nga fusha e interesit të përbashkët;
9. Bashkëpunimi edhe në fusha tjera, krahas fushave dhe veprimtarive që ushtrojnë të dyja subjektet.

Neni 3

Palët

Ky Memorandum përfshinë bashkëpunimin e Dhomës së Tregtisë dhe Komunës së Lipjanit.

Neni 4

Kohëzgjatja

1. Palët në marrëveshje do të kenë përgjegjësi të plotë gjatë përgatitjes së projekteve nga fushat e bashkëpunimit;
2. Palët në marrëveshje pajtohen që gjatë implementimit të projekteve dhe aktiviteteve nga fushat e cekura të mos cenojnë veprimtarinë e palës tjetër.

Neni 5

Zbatimi i memorandumit

1. Kjo marrëveshje nuk detyron ligjërisht asnjërën palë, mirëpo shërben si marrëveshje e vullnetit të mirë mes të dy palëve;
2. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, palët pajtohen që të bashkëpunojnë, duke përfshirë ofrimin e këshillave profesionale për bizneset në fusha të ndryshme;
3. Me qëllim të ruajtjes së të dhënave personale, palët pajtohen që të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.06/L-082, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i publikuar në Gazetën Zyrtare më dt.20.02.2019.

A.S. V.P.

Neni 6

Vlefshmëria, ndryshimet dhe plotësimet

1. Memorandumi nënshkruhet në afat të pacaktuar;
2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij memorandumi bëhen me pajtim të të dyja palëve;
3. Ky Memorandum do të përfundojë me marrëveshje nga të dyja palët ose me tërheqje nga njëra palë, duke e njoftuar me shkrim palën tjetër 30 ditë më parë.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare

1. Ky Memorandum përpilohet nga katër kopje identike, për secilën palë nga dy kopje.
2. Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë




Arsim Selmonmusaj

Nënkryetar i Bordit



Komuna e Lipjanit

për 

Diamant Bytyqi

Nënkryetar i Komunës





Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



Komuna Lipjan
Opštine Lipjane
Municipality Lipjan

Dokumenti për pranim/dorëzimin e të mirave materiale, të përfituar nga Granti i Përformances për Mjedis të Pastër

Procesverbali i dorëzimit të pajisjeve

Komuna përfituese	Lipjan
Qeveria e Republikës së Kosovës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës
Titulli i Projektit:	Skema e Grantit të Performancës Komunale- Mjedis i Pastër
Autofshisa në listën e bashkëngjitur është dorëzuar me datë	25.07.2023
Nga (emri dhe pozita)	Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI, z. Izedin Bytyqi
Përfaqësuesi i Institucionit zbatues të projektit (emri dhe pozita)	Kryetar i komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti

Autofshisa e fituar, duhet te jetë funksional dhe në gjendje operimi me qëllim që të sigurohet shërbim efikas dhe kualitativ në tërë territorin e komunës.

Me dorëzimin e pajisjeve, të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me pajisjet e listuara i barten komunës. Megjithatë, pajisjet do të jenë në dispozicion të pakufizuar të komunës.

Automjeti i fituar	Autofshisë, Modeli TIMAN 3330, Tipi 712000, Tipi 712000, „Suction swwper,kw.24 Ccm;962,Ulese 1,Viti i prodh,2023,me nr.të shasisë: 712000x01x1110 AutofshiseModeli TIMAN 3330, Tipi 712000, Suction swwper,kw.24 Ccm;962,Ulese 1,Viti i prodh,2023me nr.të shasisë:712000x01x1111
--------------------	---

Vendi, data dhe nënshkrimi

Dorëzuar nga MMPHI



Pranuar nga Komuna e Lipjanit





Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Dorëzimi në Komunën e Lipjanit

Artikulli Nr.	Përshkrim	Copë	Qmimi €
1	Autofshisë, Modeli TIMAN 3330, Tipi 712000, Suction swwper, kw.24 Ccm:962, Ulese 1, Viti i prodh, 2023, me nr. të shasisë : 712000x01x1110	1	73,516.36 €
2	Autofshisë, Modeli TIMAN 3330, Tipi 712000, Suction swwper, kw.24 Ccm:962, Ulese 1, Viti i prodh, 2023, me nr. të shasisë : 712000x01x1111	1	73,516.36 €
	Sasia totale		147,032.72 €

Data e marrjes:

Nënshkrimi dhe vula


Z. Imri Ahmeti



DORËZUESI: Institucioni Mikrofinanciar FINCA Kosovë
PRANUESI: Komuna e Lipjanit
DATA E DORËZIM/PRANIMIT: Nëntor 2023
LËNDA: Dorëzimi/Pranimi i fidaneve


Institucioni Mikrofinanciar FINCA Kosovë, me adresë në rrugën Robert Doll, nr. 112 Prishtinë, sot me datë 16 Nëntor 2023 i dorëzoi Komunës së Lipjanit 60 (gjashtëdhjetë) fidane te vendi përkatës i mbjelljes së fidaneve, mbjelljen e të cilave do t'a realizoj Komuna e Lipjanit.

Dorëzoi:



FINCA Kosovë

Pranoi:



Komuna e Lipjanit



Komuna Lipjan

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLICA OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Pranuar me: Primljeno: 17.08 2023		
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
01-413/01-44206		



Islamic Relief Kosova

Marrëveshje bashkëpunimi / Agreement

Ndërmjet / Between

Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office

dhe / and

Komuna Lipjan/ Municipality of Lipjan

Për realizimin e projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) dhe Komuna e Lipjanit në lidhje me bashkimin e mjeteve/fondeve për projektin Përkrahja e fermerëve në Kosovë që është pjesë e projektit të IRW me pin kod numër 020_004720 përkrahur nga zyra e Islamic Relief në Switzerland

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

- 1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përcaktojë formën e bashkëpunimit mes IRW dhe Komunës me qëllim të implementimit dhe finalizimit të projektit që ka për qëllim jetesen e qendrueshme dhe gjenerimin e te ardhurave përmes Moto kultivatoreve dhe serave
- 1.2 Përfitues nga ky projekt do të jenë të gjithë banoret e Komunës së Lipjansë që llogaritet të jenë rreth 57, 605 banorë. Prej tyre përfitues direkt përafërsisht llogaritet të jenë:
- 199 familje fermeresh
 - 95 familje me sera dhe
 - 104 moto kultivator

For the realization of the humanitarian project through the service of conditions between Islamic Relief Worldwide - office in Kosovo (IRW) and the Municipality of Lipjan regarding the join funds / donations for the project Support of agriculture of poor families in Kosova - for the Municipality of Lipjan which is part of the IRW project with pin code number 020_004720 supported by Islamic Relief office in Zvicërr

Article 1

Purpose of the agreement

- The purpose of this agreement is to determine the form of cooperation between IRW and the Municipality in order to implement and finalize the project that aims sustainable livelihoods and income generation through Multi cultivators and Greenhouses
- 1.2 Beneficiaries of this project will be all residents of the Municipality of Lipjan which is estimated to be about 57, 605 inhabitants. Of these, the direct beneficiaries are approximately:
- 199 Family farms
 - 95 family wih greenhouses
 - 104 moto kultivator



3.2.2 Total vlera e projektit është € 228,044.96
(Dyqind e njetzet e tete mijë e dyzet e kater euro e nentedhjete e gjashte cent)

**Neni 4
Përgjegjësitë e palëve**

4.1 Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përmbushur përgjegjësitë sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse në çdo kohë komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas Marrëveshjes, menjëherë do të njoftojë IRW - Koordinatorën e Programit si dhe e kundërta.

4.2 Të dyja palët bien dakord për të emëruar koordinatorët për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje.

4.3 Koordinatorët do të jenë përgjegjës për rolet e institucionit të tyre dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

4.4 Personi kontaktues i caktuar nga Komuna pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje si dhe personi kontaktues i caktuar nga IRW pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje.

**Neni 5
Koordinatorët**

6.1 Koordinatori për IRW

Emri:

Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, NO. 10/ A

Prishtinë, Republika e Kosovës

Zyra Telefon: 038/232-431 /

6.2 Koordinatori për Komunë

Emri:

Adresa:

Telefoni:

Tel/Fax:

Email:

3.2.2 The total value of the project is € 228,044.96
(Two hundred twenty eight thousand, and forty four euros and ninety six cent)

**Article 4
Responsibilities of the parties**

4.1 It is understood by both parties to this Agreement that each party must be capable of fulfilling its responsibilities under this Agreement. If at any time the municipality is unable to perform its functions under the Agreement, it shall immediately notify IRW - Program Coordinator and vice versa.

4.2 Both Parties agree to appoint coordinators for the successful implementation of this Agreement.

4.3 The Coordinators shall be responsible for the roles of their Institution and for ensuring the successful implementation of the articles of this Agreement.

4.4 The Contact Person designated by the Municipality agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement and the Contact Person designated by IRW agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement.

**Article 6
Coordinators**

6.1 IRW Coordinator

Name:

Address: Bajram Kelmendi Street, NO. 10 / A

Pristina, Republic of Kosovo

Office Phone: 038/232-431 /

6.2 Coordinator for the Municipality

Name:

Address:

Phone:

Tel / Fax:

E-mail:



ANNEX A

Participimi	IRW	Lipjan	Total	IRW %	Lipjan %
Direkt Sera	77,000.00	55,600.00	132,600.00	58.07%	41.93%
Direkt Motokultivator	41,250.00	36,800.00	78,050.00	52.85%	47.15%
Indirect Monitoring field visits etc	9,746.96	7,648.00	17,394.96		
Totals:	127,996.96	100,048.00	228,044.96	56.13%	43.87%



3-5000035



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Pranuar me: Primljeno: 25.08.2023		
Njësia Jednica	Numr. Broj	Shtojca Dodatak
01-352/01-46167		



KOMPANIA REGIONALE PASTRIMI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Më datë: 25.08.2023

E lidhur në mes:

Komunës së Lipjanit më tej 'Komuna', me adresë në Rrugën " Shqipëria", nr. 28 në Lipjan, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – z.Imri Ahmeti

dhe

Kompanisë Rajonale për Mbeturina "Pastrimi" SH.A , më tej "Kompania" me adresë në rrugën "Tahir Zajmi" Nr.5 në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kryeshefi Ekzekutiv, z.Petrit Reçica

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi në mes Komunës së Lipjanit dhe Kompanisë Rajonale "Pastrimi" SH.A, është ofrimi i ndihmës për participim –subvencionim në pagesën e 6 (gjashtë) punëtorëve sezonal të Kompanisë për periudhën prej 6 muajve.
2. (Prej muajit shtator 2023 deri në Shkurt 2024) për kryerjen e punëve në menaxhimin e mbeturinave, si në vijim:
 - 2.1.Largimin e deponive ilegale;
 - 2.2.Largimin e mbeturinave voluminoze;
 - 2.3.Pastrimin e sipërfaqeve publike;
 - 2.4.Punët tjera,varësishtë nga nevoja në terren,për të ndihmuar Njësinë e Kompanisë në Lipjan në grumbullimin e mbeturinave.

Neni 2

Vlera e financimit

1. Vlera e përgjithshme për pagesën e punëtorëve sezonal,sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje është në shumë prej 16.200.00 €.

2. Në pagesën –subvencionimin e punëtorëve sezonal, Komuna e Lipjanit do të participoj – subvencionoj me mjete financiare në shumë prej 8.100.00 €.
3. Në pagesën e punëtorëve sezonal, Kompania Rajonale e Mbeturinave ‘Pastrimi’ SH.A, do të participoj me mjete financiare në shumë prej 8.100.00 €
4. Paga mujore për 6 punëtorët sezonal sipas kësaj marrëveshje caktohet në shumë prej 450 € në muaj për secilin punëtor për periudhën 6 mujore ashtu që 50% e pagës paguhet nga Kompania dhe 50% subvencionohet nga Komuna.

Neni 3 Obligimet e Komunës

1. Komuna e Lipjanit obligohet që për pagesën e punëtorëve sezonal ,sipas kësaj marrëveshje të siguroj mjete financiare në shumë prej 8.100.00 €.nga buxheti i Komunës.
2. Të caktoj një përfaqësues nga Komuna e Lipjanit në cilësinë e mbikëqyrësit të realizimit të punëve në terren sipas kësaj marrëveshjeje.
3. Komuna e Lipjanit mjetet financiare në shumë prej 8.100.00 €, do t’i transferoj në llogaritë bankare të secilit punëtor sezonal në baza mujore.

Neni 4 Obligimet e Kompanisë

1. Kompania Rajonale e Mbeturinave ‘Pastrimi’ SH.A , obligohet që për pagesën e 6 punëtorëve sezonal të siguroj mjete financiare në shumë prej 8.100.00 €.për ngritjen e kualitetit të grumbullimit të mbeturinave për interesin e përgjithshëm të qytetarëve.
2. Kompania Rajonale e Mbeturinave ‘Pastrimi’ SH.A – Njësia në Lipjan, në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit monitoron mbarëvajtjen e menaxhimit të mbeturinave dhe punëve tjera mjedisore në funksion të pastrimit të hapësirave publike në terren.
3. Kompania Rajonale e Mbeturinave ‘Pastrimi’ SH.A, duhet t’i dorëzoj raport me shkrim Komunës së Lipjanit për realizimin e punëve në terren si dhe për shpenzimin e mjeteve të destinuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5 Zbatimi

Kjo Marrëveshje është e zbatueshme dhe e vlefshme deri në përmbushjen e obligimeve nga të dyja palët.

Neni 6 Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet e krijuara nga Marrëveshja e Bashkëpunimit duhet të zgjidhen përmes bisedimeve midis palëve. Nëse dështojnë bisedimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët do t’i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 7
Numri i kopjeve

Marrëveshja e Bashkëpunimit është përpiluar në kopje identike dhe të mjaftueshme për secilen palë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy palët nënshkruese.

Nënshkruar më datë: 25.08.2023

KRM "Pastrimi" SH.A


Petrit Reçica



Kryetari i Komunës


Imri Ahmeti





KRYEQYTETI
PRISHTINA

KOMUNA
PODUJEVËS

KOMUNA
LIPJANIT

KOMUNA
FUSHË KOSOVËS

KOMUNA
GRAÇANICËS

KOMUNA
OBILIQIT



Me qëllim bashkëpunimi si dhe synimit të shndërrimit të rajonit në një zonë funksionale metropolitane, në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal të Republikës së Kosovës, ne të poshtshënuarit pajtohemi për të nënshkruar këtë:

Pranuar më:	21.12.2023	
Prilijeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-660/03-69356		

MARRËVESHJE KORNIZË E BASHKËPUNIMI NDËRKOMUNAL SHUMË-FUNKSIONAL

NDËRMJET

1. Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina (tani e tutje, Kryeqyteti), i përfaqësuar nga Kryetari i Kryeqytetit;
2. Komuna e Podujevës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
3. Komuna e Lipjanit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
4. Komuna e Fushë Kosovës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
5. Komuna e Graçanicës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës;
6. Komuna e Obiliqit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës.

Neni 1 QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është bashkërendimi i aktiviteteve në mes të Kryeqytetit dhe pesë (5) komunave fqinjë, në fusha të ndryshme, me interes të përgjithshëm, me të cilin do të krijohen lehtësira për mirëqenien e qytetarëve të Kryeqytetit dhe këtyre Komunave, në sfera të ndryshme të jetës.

Neni 2 FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. FUSHA E MIRËQENIES SOCIALE

Palët nënshkruese pajtohen:

1. Të bashkëpunojnë në ofrimin e strehimit të përkohshëm për personat në nevojë, nënat të cilat i nënshtrohen dhunës në familje, nënave vetushqyese, fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të miturve pa përkujdesje, etj.;
2. Që Kryeqyteti dhe secila komunë të mbajë përgjegjësinë për krijimin e hapësirave për trajtim, kujdesie, edukim dhe argëtim të fëmijëve në situata rruge (lëmoshë-kërkuesve), të cilët janë banorë të komunave;
3. Në rrethana të caktuara, në veçanti në mungesë të hapësirës/kushteve në njërin nga komunat të cilat janë nënshkruese të marrëveshjes, të gjithë të bashkëpunojnë në mënyrë që asnjë fëmijë të mos mbetet në rrugë;
4. Të krijojnë kushte banimi për rastet sociale.

2. FUSHA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Palët nënshkruese pajtohen:

1. Të ndërtojnë një plan të përbashkët mobiliteti, i cili do të përfshinte të gjitha çështjet e ndërlidhura me trafikun dhe shtigjet për biçikleta, si:

- 1.1 Zhvillimi i një vizioni dhe strategjie të re të transportit;
- 1.2 Transporti publik;
- 1.3 Modalitetet e udhëtimit aktiv;
- 1.4 Sistemi rrugor dhe parkimi;
- 1.5 Menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore;
- 1.6 Planifikimi për mobilitetin e qëndrueshëm urban;
- 1.7 Investimet dhe financimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU);
- 1.8 Struktura institucionale e PMQU-së;
- 1.9 Bashkëpunim në transportin e udhëtareve dhe funksionalizim i linjave:

- Prishtinë - Fushë Kosovë;
- Prishtinë - Obiliq; dhe
- Graçanicë – Prishtinë; me fshatrat e Kryeqytetit që kalojnë përmes territorit të Graçanicës, përfshirë linjat:
 - Prishtinë - Mramur;
 - Prishtinë - Shashkovc;
 - Prishtinë - Kishnicë;
 - Prishtinë - Qendra Tregtare Prishtina Mall; dhe
 - Prishtinë – Janjevë;
- 1.10 Sistemin e sigurisë rrugore në afërsi të institucioneve shkollore;
- 1.11 Rregullimin e sistemit të trafikut rrugor;

- 1.12 Zhvillimin e planit/veprimit ndër-komunal mbi menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.13 Implementimin e rrjetit të shtigjeve të biçikletave; dhe
 - 1.14 Marrëveshja për implementimin e masave të parapara në PMQU.
2. Ndërtimin e një impianti të përbashkët për ujërat e zeza;
 3. Menaxhimin e përbashkët të mbeturinave - deponitë e mbeturinave;
 4. Përmirësimin e cilësisë së ajrit, në mënyrë që të përmbushen standardet e BE-së, si dhe rregullimin e ambientit, përfshirë lumenjtë dhe ruajtjen e pyjeve, duke ndërmarrë aktivitete të përbashkëta, si:
 - 4.1 Hartimin e planit të strategjisë për identifikimin e ndotësve të ajrit dhe projekteve të përbashkëta, të cilat mund të zbatohen së bashku;
 - 4.2 Identifikimi i sipërfaqeve/zonave të degraduara, të cilat kanë nevojë për trajtim dhe mbjellje të drunjëve;
 - 4.3 Përcaktimi dhe specifikimi i llojeve të drunjëve halorë ose atyre gjethe-gjerë që kanë mundësi më të madhe absorbimi, përreth kufirit Prishtinë – Obiliq, si dhe krijimi i një bufer (tampon) zone për uljen e nivelit të ndotjes së ajrit;
 - 4.4 Vendosja e monitorëve për matjen e ndotjes së ajrit në nivel ndër-komunal me sensorë (matës) të përbashkët;
 - 4.5 Aktivitete të përbashkëta mjedisore, si fushatat vetëdijesuese për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe zhurmës, me nxënës të shkollave ndër-komunale (së bashku me zyrën e mjedisit);
 - 4.6 Pyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara (së bashku me Drejtoritë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural);
 - 4.7 Rregullimi i problemit të mbeturinave nga miniera e Kishnicës që shkaktojnë ndotjen e ajrit në mes komunës së Gracanicës dhe komunës së Prishtinës;
 5. Bashkëpunimin ndër-komunal, gjatë sezonës së dimrit, në transportin ndër-urban; të konsiderohen mundësitë e organizimit të transport falas në muajt e dimrit, kur ka probleme me kushtet metrologjike, siç janë temperaturat e ulëta dhe krijimi i smogut, të dëmshëm për shëndetin e njeriut, me qëllimin e reduktimit të përdorimit të transportit privat/personal.

3. FUSHA E SPORTIT

Palët nënshkruese pajtohen të bashkëpunojnë për aktivitete sportive, siç janë klubet e qyteteve, si në organizime të përbashkëta ashtu edhe në mundësinë e shfrytëzimit të hapësirave sportive të ndërsjella.

4. FUSHA E KULTURËS

Palët nënshkruese pajtohen të bashkëpunojnë në nisma të ndryshme kulturore me interes të përbashkët, si:

1. Koncerte për të rritur dhe fëmijë;
2. Festivale kombëtare e ndërkombëtare;
3. Mbështetja e artistëve, përkrahja e aktiviteteve të përbashkëta kulturore, si dhe promovimi i njohurive të përbashkëta të ndërsjella në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore; dhe
4. Krijimi i një harte digjitale të kulturës së përbashkët rajonale në mes të komunave.

5. FUSHA E ARSIMIT

Palët nënshkruese pajtohen:

1. Të krijojnë një mekanizëm të përbashkët, në mes të DKA-ve të komunave nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, për të komunikuar në rastet e urgjencave që dalin në arsim;
2. Së bashku me drejtoritë kompetente për çështjet e sigurisë, të bashkëpunojnë edhe për çështjen e sigurisë në shkolla, përfshirë shkëmbimin e planeve të veprimit;
3. Të hulumtohen veprimet adekuate, përfshirë elementet financiare, në mënyrë që t'u mundësohet të gjithë nxënësve nga rajoni të regjistrohen në shkollat e mesme sipas zgjedhjes së tyre; dhe
4. Të konsiderohen mundësitë e organizimit të përbashkët, përfshirë pjesën financiare, të transportit për nxënësit e fshatrave që ndodhen afër shkollave të komunave fqinjë.

6. FUSHA E SHËNDETËSISË

Palët nënshkruese pajtohen që në fushën e shëndetësisë të bëhet koordinimi i shërbimeve shëndetësore, përfshirë spitalin e kryeqytetit, si dhe bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë primare dhe sekondare.

Fokusi i bashkëpunimit të përqendrohet edhe në nivelin primarë, në këto fusha:

1. Koordinimi i shërbimeve të integruara shëndetësore në kujdesin primarë (shërbimeve të përbashkëta shëndetësore dhe sociale);
2. Të zhvillohet një data-bazë ndër-komunale për kujdes të integruar, e që do të ndihmonte në avancimin e qasjes dhe përmirësimin e shërbimeve të integruara, për kategoritë e pacientëve me sëmundje kronike jo-ngjitëse, si: hipertensioni, diabeti, astma, sëmundjeve tjera fizike, sëmundjeve të shëndetit mental dhe të sjelljes, etj. Data-baza do të mundësonte edhe sigurimin e të dhënave, përgatitjen dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse;
3. Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta shëndetësore urgjente;
4. Shkëmbimi i përvojave dhe angazhimi i përbashkët në ngritjen e kapaciteteve të personelit mjekësorë;
5. Bashkëpunim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për nënat e reja dhe fëmijët deri në moshën tre vjeçare;
6. Bashkëpunim dhe përkrahje në mes të komunave me barna esenciale, siç është ofrimi i oksigjenit në raste të veçanta, si pandemia, etj.;
7. Koordinim në luftimin dhe parandalimin e TBC-së, e cila sëmundje, për shkak të pandemisë, mund të pësoj rritje në vitet në vijim;
8. Bashkëpunim në fushën e diagnostikës dhe shërbimeve laboratorike;
9. Bashkëpunim në gjetjen e formave dhe modaliteteve për motivimin e mjekësisë familjare; motivimi i mjekëve familjarë për të qëndruar në institucionet e kujdesit primarë shëndetësorë dhe për tu specializuar në mjekësi familjare;
10. Bashkëpunim në hartimin, implementimin dhe promovimin e programeve parandaluese për sëmundjet e rënda, si: sëmundjeve kardiovaskulare, kancerit colorectal, kancerit cervikal, etj.

7. FUSHA E BUJQËSISË

Palët nënshkruese pajtohen që në fushën e bujqësisë të bashkëpunojnë me aktivitete dhe projekte të ndryshme, si:

1. Organizimi i panairove të përbashkëta ndër-komunale të prodhimeve bujqësore si dhe njësive agro-përpunuese;
2. Bashkëpunim ndër-komunal në fushën e turizmit rural;
3. Bashkëpunim në fushën e terreneve të gjuetisë;

4. Takime të rregullta për shkëmbim përvojash dhe ideve për projektet e ndryshme të granteve, subvencioneve dhe mbështetje financiare për fermerët e komunave përkatëse;
5. Takime ndër-komunale për ofrimin e shërbimeve këshillimore në fusha të ndryshme bujqësore për fermerë;
6. Bashkëfinancim ndër-komunal për realizimin (aplikimin) e projekteve në fushat me interes të ndërsjellë.

8.FUSHA E SIGURISE DHE EMERGJENCAVE

Palët nënshkruese pajtohen që në fushën e sigurisë dhe emergjencave të bashkëpunojnë me aktivitete dhe projekte të ndryshme, si:

1. Të koordinohen dhe të reagojnë në mënyrë të përbashkët në raste të emergjencave;
2. Të krijojnë një mekanizëm të përbashkët, në mes të drejtorive relevante të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, për të komunikuar dhe koordinuar në rastet e sigurisë dhe emergjencave;
3. Të ndërtojnë një qasje të përbashkët dhe bashkëpunim të ngushtë për trajtimin e qeneve endacakë, përfshirë masat afatshkurta, afatmesme dhe ato afatgjate, çdoherë në koordinim me pushtetin qendrorë. Në kuadër të masave afatgjate, komunat pajtohen të ndërtojnë një Strehimore Rajonale të Kafshëve, me theks në qentë endacakë, por edhe ata me pronarë. Kryeqyteti, tanimë ka ndarë një parcelë dhjetë-hektarësh për këtë qëllim, derisa me komunat fqinjë do të koordinohemi dhe do të bashkëpunojmë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e përbashkët të qendrës.

9.TJERA

Të hulumtohen format e përshtatshme për avancimin e bashkëpunimit multi-etnik në mes të Komunës së Graçanicës dhe palëve tjera nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.

Neni 3 PLANET ZBATUESE

1. Kuvendi i Kryeqytetit dhe Kuvendet e pesë Komunave tjera, autorizojnë Kryetarët/et e tyre që, për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve nga fushat e bashkëpunimit, të përshkruara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, të hartojnë planet e detajuara zbatuese, të cilat pastaj do të aprovohen dhe nënshkruhen nga Kryetarët përkatës të Komunave pjesëmarrëse.
2. Këto plane zbatuese duhet të përfshijnë dhe të plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore të parapara në Ligjin Nr. 04/1-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, përfshirë afatet kohore dhe kushtet për tërheqje nga marrëveshja.

Neni 4 NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I MARRËVESHJES

Në rast nevojë dhe me pëlqimin e palëve, kjo marrëveshje e bashkëpunimit mund të ndryshohet dhe plotësohet në formë të shkruar.

Neni 5 PËLQIMI I PALËVE

Mospajtimet ose interpretimet eventuale të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.

**Neni 6
HYRJA FUQI**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit të kryetarëve dhe aprovimeve në kuvendet relevante, sipas procedurave të parapara në Ligjin nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal.

**Neni 7
TË NDRYSHME**

1. Komunikimi ndërmjet palëve lidhur me këtë marrëveshje do të bëhet me shkrim.
2. Kjo marrëveshje është përpiluar në 6 (gjashtë) kopje identike dhe në dy gjuhë, me përmbajtje të njëjtë, e të cilat kanë të njëjtin efekt juridik.

KRYEQYTETI, PRISHTINA

Përparim Rama



KOMUNA E PODUJEVËS

Shpejtim Bulliqi



KOMUNA E LIPJANIT

Imri Ahmeti



KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Besnik Osmani



KOMUNA E GRAÇANICËSË

Leutrim Ajeti



KOMUNA E OBILIQIT

Xhafer Gashi



REPUBLIKA KOSOVO
PRISHTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno:	22.09 20 23	
Njësia Jednicë:	Numri Braj	Shtojca Dodatak
01-451 / 01-54519		



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	4760/2023
Data Datum Date	20.09.2023
Nënshkrimi Çopis Signature	
PRISHTINË, PRISHTINA, PRISHTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

ANEKS MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

KOMUNËS SË LIPJANIT

1. QËLLIMI I KËTIJ ANEKS MEMORANDUMI TË BASHKËPUNIMIT

Qëllimi i këtij Aneks Memorandumi të Bashkëpunimit është amandamentimi i Memorandumi të Bashkëpunimit të datës 31.03.2020 me numër të protokollit 1181/2020 i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Lipjanit, për mbështetjen financiare nga MKRS për projektin “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Lipjanit”.

2. AUTORITETET

Ky Aneks Memorandum do të përmbushet nga:

- 2.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- 2.2. Komuna e Lipjanit.

(në tekstin e mëtejshëm: Palët)

3. AFATI I REALIZIMIT

Ndryshohet - Plotësohet neni një (1) i Memorandumi të Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Lipjanit i datës 31.03.2020 dhe me numër të protokollit 1181/2020, për projektin “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Lipjanit”.

Periudha e realizimit të projektit për mbështetje financiare nga MKRS për projektin “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Lipjanit” vazhdohet deri në fund të vitit 2023.

4. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Ky Aneks Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

5. HYRJA NË FUQI

Ky Aneks Memorandum i Bashkëpunimit, hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.


Hajrulla ÇEKU
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Nënshkruar më 20/09/2023
Prishtinë


Imri AHMETI
Kryetar i Komunës së Lipjanit

Pranuar me: Primljeno:	27-09 20 23	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/d1-55356		

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME-MINISTARSTVO UNUTRASNIJH POSLOVA MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS AGJENCIA PER MENAXHIMIN EMERGJENT AGENCIJA ZA UPRAVLJANJE VANREDNIM SITUACIJAMA EMERGENCY MANAGEMENT AGENCY			
Nr./Br.No.	117	Nr./Br.No./No.pq	4
Data/Datum/Date	27-09-2023		
PRISHTINE A			



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



**Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs**
**Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja/
Emergency Management Agency**

Prishtinë, __/__/2023

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËFINANCIM

NDËRMJET

**AGJENCISË SË MENAXHIMIT EMERGJENT –MINISTRIA E PUNËVE TË
BRENDSHME**

DHE

KOMUNËS SË LIPJANIT

PËR

**BASHKËFINANCIM DHE REALIZIM TË PROJEKTIT “NDËRTIMI I OBJEKTIT PËR
NJPZSH DHE RREGULLIMI I OBORRIT**

Agjencia e Menaxhimit Emergjent- Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme “AME/MPB”), rruga “Dëshmorët e Gollakut ” pn. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, në njërën anë, dhe

Komuna e Lipjanit, Republika e Kosovës (në tekstin e mëtejme “Komuna”), rruga "Shqipëria" nr 28 " PN , Republika e Kosovës, në anën tjetër.

Në tekstin vijues të referuara bashkërisht si “Palët”, janë pajtuar si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit “Ndërtimi i objektit për NJPZSH dhe rregullimi i oborrit ” si dhe përcaktimi i obligimeve të AME-së dhe komunës së Lipjanit për realizimin e këtij projekti.

Neni 2 Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Projekti “Ndërtimi i objektit për NJPZSH dhe rregullimi i oborrit”
2. AME-ja nga buxheti i saj do të financoj 80% të projektit.
3. Komuna e Lipjanit nga buxheti do të financoj ne këtë projekt 20%.
4. Vlera e projektit do të përcaktohet pas revidimit të projektit model.
5. Pagesat do të realizohen sipas % (përqindjes se financimit) të cekur në nenin 2 dhe 3. Nëse gjatë revidimit të projektit bazë ,konstatohet se vlera e projektit do të rritet për objektin atëherë këtë pjese do të financoj AME-ja përmes buxhetit të saj .

Neni 3 Obligimet e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent

1. AME-ja është e obliguar që pas pranimin të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar dhe të protokolluar, të hartoj projektin zbatues, si dhe të siguroj tërë dokumentacionin e nevojshëm që projekti nuk do të ketë pengesa në realizim.
2. AME-ja obligohet të siguroj deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së parallogaritur të projektit dhe një kopje ta dërgoj në Komune.
3. AME-ja obligohet që projektin ta zhvilloj në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik të Kosovës, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-237, Ligjin Nr. 05/l-068, Ligjin Nr. 05/l-092 dhe Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet nënligjore.
4. AME-ja është bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit sipas ligjit në fuqi. Procedurat e prokurimit, AME-ja duhet t'i filloj brenda 30 ditë kalendarike pas nënshkrimit të marrëveshjes, në të kundërtën në mënyrë të njëanshme mund të ndërpres marrëveshjen.
5. AME-ja obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me OE të sjellë një kopje të kontratës identike me origjinalin në Komune , së bashku me informatat për biznesin, me qëllim të sigurimit të nxjerrjes së urdhër-blerjes (numrin e biznesit dhe numrin e llogarisë bankare).
6. AME-ja cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit, si dhe bën inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.

7. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

8. AME-ja obligohet që të njoftoj Komunën për çdo propozim-ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, ndërsa për punime shtesë duhet të merret aprovim nga Komuna (për pjesën e financuar nga Komuna).

9. AME-ja duhet të vendos tabelën informuese standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik në vend punishte.

10. AME-ja duhet të ndërmerr të gjitha masat që të bëhet kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe që të filloj me procedurat e prokurimit gjatë vitit buxhetor 2023 dhe varësisht nga plani dinamik duhet të përfundoj brenda vitit 2024-2025.

11. AME-ja është e obliguar të njoftoj Komunën për rrjedhat e realizimit të projektit sipas dinamikës së punimeve deri në përfundim të projektit.

12. AME-ja obligohet që pas përfundimit të projektit dhe obligimeve kontraktuale, të njoftoj Komunën përmes dokumentacionit përkatës me të cilin dëshmohet përmbyllja e projektit.

Neni 4 Obligimet e Komunës

1. Komuna e Lipjanit i zoton mjetet për projektin nga neni 2, paragrafi 3 i kësaj marrëveshje dhe një kopje e dërgon në AME.

2. Pagesat për projektin “Ndërtimi i objektit për NJPZSH dhe rregullimi i oborrit”, do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve sipas kushteve të kontratës, në rastin e bashkëfinancimit të projektit,

3. AME-ja me rastin e formimit të komisionit për procedurat e prokurimit dhe tenderimit, duhet të kërkoj nga Komuna e Lipjanit një përfaqësues si anëtar komisioni, anëtar i cili duhet të marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve dhe në procesin e vlerësimit të tenderëve.

Neni 5 Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga AME

1. AME-ja obligohet që për t’i realizuar pagesat për punët e kryera deri në shumën e financimit nga ana e Komunës, të kompletoj dokumentacionin si në vijim:

1.1 Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të AME-së;

1.2 Kopjen e deklaratës të disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së parallogaritur të projektit;

1.3 Vendimin për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e komunës;

1.4 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët e kryera dhe të aprovuara (situacionet);

- 1.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar deri në shumën e financuar nga Komuna ;
- 1.6 Sigurimin e ekzekutimit, garancinë e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës;
- 1.7 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

Neni 6 Pronësia e projektit

1. Me pranim-dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit, do të kaloj në shfrytëzim të NJPZSH ne Lipjan .

Neni 7 Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të palëve-Drejtorit të AME -së dhe Kryetarit të Komunës, marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. Palët mbajnë të drejtën e ndërprerjes së marrëveshjes në rast se konstatohet se ndonjëra nga palët nuk i përmbushin obligimet e veta të dala nga kjo marrëveshje.

Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët zotohen se do të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë marrëveshje bashkëpunimi, ashtu siç parashihet në të. Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet që në mënyrë miqësore t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet eventuale në lidhje me këtë marrëveshje.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Drejtori i Përgjithshëm i AME -së dhe Kryetari i Komunës.

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Shefki Abdullahu

Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të AME-së



Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit






Komuna e Lipjanit
Municipality of Lipjan

REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

Pranuar me: Priljeno:	31.07.2023	
Njësia Jednic:	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-360/01-	39441	



MARRËVESHJE PËR MIRËKUPTIM DHE BASHKËPUNIM Ndërmjet

KOMUNËS SË LIPJANIT

dhe

OJQ-SË "BANIMI SOCIAL DHE TË DREJTAT PRONËSORE NË KOSOVË"

Pas bisedimeve dypalëshe për bashkëpunim, me datën 01.08.2023 është arritur marrëveshja në vijim ndërmjet Komunës së Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari z. Imri Ahmeti dhe OJQ-së "Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë", e njohur me shkurtësën angleze SHPRK (Social Housing and Property Rights in Kosovo) të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv z. Agron Beka.

Neni 1 - Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim (MMB) është që përmes nënshkrimit të saj, Komuna e Lipjanit dhe OJQ SHPRK, obligohen që të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet që do të ndërmarrin lidhur me mbështetjen dhe lehtësimin e ndërsjellë nga të dyja palët për projekte të përbashkëta nga të cilat përfitojnë banorët e Komunës së Lipjanit.

Neni 2 - Obligimet e SHPRK-së

1. SHPRK synon të sigurojë fonde nga SIDA Suedeze për tri vitet e ardhshme 2023-2026, për të mbështetur komunitetet në nevojë për çështjet pronësore duke ofruar ndihmë juridike falas.
2. SHPRK do të aplikojë edhe tek organizata të tjera ndërkombëtare dhe vendore për sigurimin e fondeve për realizimin e projekteve të ndryshme me interes të përgjithshëm.
3. SHPRK do të përfshijë zyrtarët e drejtorive përkatëse në grupin e interesit në të gjitha projektet që do të realizohen në Komunën e Lipjanit.
4. SHPRK-ja, pasi të jetë ftuar, obligohet të marrë pjesë në mbledhjet e organizuara nga komuna ku diskutohen çështjet të ndryshme në interes të përbashkët.
5. SHPRK merr përsipër të informojë Komunën për aplikime për projektet që do t'u dërgohen donatorëve të ndryshëm, dhe qëllimi i të cilave është zbatimi në Komunën e Lipjanit.

Neni 3 -Obligimet e Komunës së Lipjanit

1. Komuna do të sigurojë kushte minimale për punën e zyrtarëve të SHPRK-së si qasje të lehtësuar në ambientet e saj duke u mundësuar hyrjen në ndërtesë;
2. Komuna do t'i japë SHPRK-së informacion se drejtoritë që janë të involvuara me projektet e SHPRK-së janë të informuara lidhur me projektet dhe se këto drejtori do t'u japin përparësi të kërkesave të SHPRK-së kurdo që të jetë e mundur;
3. Komuna do të siguroj pjesëmarrjen e zyrtarëve të saj në punëtoritë, debatet, konferencat etj. të organizuara nga SHPRK.

Neni 4 - Afati i vlefshmërisë

Kjo MMB mbetet në fuqi nga data e nënshkrimit deri më 31 dhjetor 2026, me mundësi vazhdimi.

Neni 5 - Hyrja në fuqi dhe ndryshimi

MMB hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët.

MMB mund të ndryshohet me pëlqim reciprok me shkrim ndërmjet palëve.

Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit



Agron Beka

Drejtor Ekzekutiv i SHPRK





REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN



Pranuar më: Primlajeno:	24.10 2023	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-610/01-60676		

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv,
z. Isak Skenderi;

DHE

Komunës së Lipjanit - përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës ;



Pranuar me: Primitjeno: 28.08.2023		
Njesia Jednica	Numri Ene	Shtojca Dodatak
04-660/03-46463		

Memorandumi i Mirëkuptimit

Ndërmjet

PLAY International, Organizatë Joqeveritare (numri i regjistrimit: 5300396-6) përfaqësuar nga Bérangère Dailly, Shefe e Misionit (në tekstin e mëtejme: PLAY)

dhe

Departamenti i Kulturës Rinisë dhe Sportit, Komuna e Lipjanit, përfaqësuar nga Anila Reqica-Llugiqi, Drejtoreshë e Departamentit për Kulturë, Rini dhe Sport (në tekstin e mëtejme: DKRS)

dhe

Departamenti i Arsimit, Komuna e Lipjanit, përfaqësuar nga Rasim Hasani, Drejtor i Departamentit të Arsimit (në tekstin e mëtejme: DKA)

PREAMBULA

Ky Memorandum i Mirëkuptimit (në tekstin e mëtejme MM) detajon marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet PLAY, DKRS dhe DKA me të drejtat dhe detyrimet e të tri palëve, si në vijim:

NENI 1: KORNIZA

Departamenti i Kulturës Rinisë dhe Sportit

DKRS punon për implementimin e politikave sportive në komunën e Lipjanit. Kjo përfshinë mbështetjen ndaj edukimit joformal, klubeve sportive dhe strukturave rinore si qendrat rinore, OJQ-të rinore, dhe mbështetë promovimin e vullnetarizmit.

Departamenti i Arsimit

DKA punon për zhvillimin dhe implementimin e politikave arsimore në komunën e Lipjanit. Kjo përfshin mbështetjen e institucioneve të arsimit formal si shkollat fillore dhe të mesme, dhe trajnimin-në-shërbim të mësimdhënësve.

PLAY International

PLAY është OJQ ndërkombëtare e regjistruar në Kosovë që nga viti 2002, ku qëllimi kryesor i së cilës është të fuqizojë të rinjtë e Kosovës dhe të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të mirë në Kosovë duke përdorur fuqinë e sportit si një mjet për të edukuar, integruar dhe fuqizuar fëmijët dhe të rinjtë e diskriminuar ose të marginalizuar.

Në kuadër të kornizes së kësaj Marrëveshjeje të Partneritetit, PLAY, DKRS dhe DKA bashkëpunojnë për implementimin e projekteve edukative të PLAY në Kosovë dhe në mbështetje të qëllimeve strategjike të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke përfshirë planet e veprimit, siç është rënë dakord midis tri palëve.

Kur është e përshtatshme dhe e disponueshme, shtojcat e këtij MM detajojnë strategjitë kombëtare dhe përshkrimet e projekteve të cilat përbëjnë bazën e kësaj marrëveshjeje:

- Shtojca 1: Strategjia e Arsimit 2022-2026
- Shtojca 2: Strategjia Kosovës për Rini dhe Plani i Veprimit 2019-2023
- Shtojca 3: Përshkrimi i Projektit Sport4Resilience (S4R)

NENI 2: PËRGJEGJËSITË E DKRS

Për implementimin e mirë të projektit, DKRS zotohet për:

1. Në Kornizen e projektit S4R:
 - a. Punon me PLAY për të lehtësuar bashkëpunimin me institucionet relevante lokale dhe me individët që do të marrin pjesë në projekt.
 - b. Jep ekspertizën dhe njohuritë e DKRS-së në projekt përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e komiteteve të projektit.
 - c. Punon me PLAY për të ndihmuar në lehtësimin e implementimit lokal të projektit.
 - d. Punon me PLAY për të identifikuar animatorët e sporteve për të marrë trajnime dhe për të implementuar aktivitetet e projektit me fëmijët lokal.
 - e. Punojë ngushtë me vullnetarët e rinjë të përfshirë në projekte për t'i ndihmuar ata në zbatimin e aktiviteteve të projekteve në nivel lokal.
 - f. Së bashku me stafin e PLAY, eksploron mënyrat për të validuar përvojën e animatorëve sportiv të certifikuar të projektit duke identifikuar mundësitë për vullnetarizëm lokal dhe përvojë të punës në sektorin e sportit komunal.
2. Në kornizen më të gjerë të partneritetit, ku është e mundur:
 - a. Lehtëson zbatimin e aktiviteteve të tjera të projektit siç është rënë dakord dhe kur është e përshtatshme;
 - b. Lehtëson marrëdhëniet midis PLAY dhe institucioneve lokale;
 - c. Informon PLAY për aktivitete që zbatohen nga qendrat rinore, OJQ-të / OSHC-të apo entitete të tjera të drejtuara për të rinjtë në komunë dhe lehtëson shkëmbimin e kontakteve;
 - d. Lehtëson qasjen në objektet sportive komunale për aktivitetet dhe ngjarjet e organizuara nga PLAY;

- e. Siguron një vend të sigurt për pajisjet sportive nëse është e nevojshme;
 - f. Ndhmon PLAY, kur është e mundur, përmes një lehtësime logjistik dhe institucional të projektit (transport komunal, kontribut në kosto) siç është rënë dakord paraprakisht;
 - g. Kontribuon në zhvillimin e përmbajtjes së trajnimit përmes ekspertizës teknike dhe merr pjesë në trajnime nëse është e mundur;
 - h. Merr pjesë në ngjarje, në bashkëpunim me PLAY dhe akterë të tjerë të përfshirë;
 - i. Fton PLAY në takimet dhe konferencat relevante që lidhen me sektorin e rinisë dhe sektorin e sportit.
5. Sigurohet për dukshmërinë e partneritetit me PLAY, përmes publikimeve përkatëse komunale, mbulimit mediatik, postimeve të mediave sociale dhe mjeteve të tjera.

NENI 3: PËRGJEGJËSITË E DKA

Për implementimin e mirë të projektit, DKA zotohet për:

1. Në Kornizen e projektit S4R:
 - a. Punon me PLAY për të lehtësuar bashkëpunimin me institucionet relevante locale dhe individët që do të marrin pjesë në projekt;
 - b. Kontribuon me ekspertizën dhe njohuritë e DKA- së në projekt, përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e komiteteve komunale të projektit;
 - c. Punon me PLAY për të ndihmuar në lehtësimin e implementimit lokal të projektit, veçanërisht në aktivitetet e trajnimit të mësimdhënësve.
 - d. Punon me PLAY për të identifikuar shkollat fillore dhe të mesme të ulta për të marrë pjesë në projekt.
 - e. Punon me PLAY për të identifikuar mësimdhënësit për tu trajnuar dhe për të implementuar aktivitetet e projektit me fëmijët e shkollës.
 - f. Punon ngushtë me vullnetarët e përfshirë në projekte për t'i ndihmuar ata në bashkëpunimin me shkollat lokale për të implementuar aktivitetet e projektit;
 - g. Mbështetë përdorimin e aktiviteteve sportive në implementimin vjetor të Ditëve Ndërkombëtare në shkollat lokale.
2. Në kornizen më të gjerë të partneritetit, ku është e mundur:
 - a. Lehtëson implementimin e aktiviteteve të tjera të projektit siç është rënë dakord dhe aty ku është e përshtatshme;
 - b. Lehtëson marrëdhëniet midis PLAY dhe institucioneve lokale të arsimit;
 - c. Informon PLAY për çdo aktivitet të trajnimit të mësuesve të implementuar në komunë dhe lehtëson shkëmbimin e kontakteve me organizatat trajnuese;
 - d. Lehtëson qasjen në objektet e arsimit komunal për aktivitetet dhe ngjarjet e organizuara nga PLAY;
 - e. Siguron një hapësirë të sigurtë për pajisjet sportive nëse është e nevojshme;
 - f. Ndhmon PLAY, kur është e mundur, përmes lehtësimit logjistik dhe institucional të projekteve (transport komunal, kontribut në kosto) siç është rënë dakord paraprakisht;
 - g. Kontribuon në zhvillimin e përmbajtjes së trajnimit përmes ekspertizës teknike dhe merr pjesë në trajnime nëse është e mundur;
 - h. Merr pjesë në ngjarje, në bashkëpunim me PLAY dhe akterë të tjerë të përfshirë;
 - i. Fton PLAY në takimet dhe konferencat relevante që lidhen me arsimin komunal.

3. Sigurohet për vizibilitetet të partneritetit me PLAY, përmes publikimeve përkatëse komunale, mbulimit mediatic, postimeve të mediave sociale dhe mjeteve të tjera.

NENI 3: PËRGJEGJËSITË E PLAY

Për implementimin e mirë të projektit, PLAY zotohet për:

1. Në Kornizen e projektit *S4R*:
 - a. Punon me DKRS dhe DKA për të krijuar partneritete me institucionet relevante vendore dhe individët që do të marrin pjesë në projekt;
 - b. Kryeson dhe organizon takimet e komiteteve komunale të projektit duke siguruar koordinim të vazhdueshëm mbi qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet e projektit;
 - c. Siguron stafin, ekspertizën dhe financimin për të implementuar dhe siguruar suksesin e projektit.
 - d. Punon me DKRS dhe DKA për të identifikuar dhe për tu bërë partnerë me organizatat lokale dhe shkollat për të marrë pjesë në projekt.
 - e. Identifikon dhe trajnon animatorët dhe mësime të vendit për të implementuar aktivitete me fëmijë.
 - f. Jep një çantë me pajisje sportive për çdo klub dhe shkollë partnere në projekt, për të implementuar aktivitetet.
 - g. Angazhon kohën e stafit për të mbështetur dhe monitoruar animatorët dhe mësime të sportit në implementimin e aktiviteteve.
 - h. Siguron stafin, ekspertizën dhe financimin për zbatimin e projektit në lokalitetet e synuara.
 - i. Ofron një përvojë të mësimit të "Animimit në Sport" me cilësi të lartë për vullnetarët pjesëmarrës nga komunitetet e ndryshme në komunë;
 - j. Mbështetë të rinjtë vullnetarë lokalë për të zhvilluar aktivitete të rregullta bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë.
2. Në kornizën më të gjerë të partneritetit, ku është e mundur:
 - a. Implementon ose kontribuon në zbatimin e aktiviteteve të tjera siç është rënë dakord dhe kur është e përshtatshme;
 - b. Kontribuon në zhvillimin e sektorëve të sportit dhe arsimit në Kosovë përmes ofrimit të përmbajtjes dhe trajnimit me cilësi të lartë si dhe pjesëmarrjes në takimet dhe konferencat lokale;
 - c. Organizon dhe merr pjesë në ngjarje të përshtatshme dukshmërie në bashkëpunim me DKRS dhe DKA;
3. Sigurohet për dukshmëri të partneritetit me DKRS dhe DKA, përmes materialeve komunikuese, mbulimit mediatic, postimeve të mediave sociale dhe mjeteve të tjera.

NENI 4: BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI

Si partnerë, vendimet strategjike që lidhen me aktivitetet e projektit në lokalitetet e synuara do të merren në bashkëpunim dhe koordinim dhe në përputhje me objektivat dhe etikën e të gjitha palëve.

Partnerët do të mbajnë kontakte të rregullta për të siguruar që zbatimi i projekteve dhe aktiviteteve të mbetet në rrugën e duhur dhe në përputhje me prioritetet e të tri organizatave/ paleve. Do të mbahen disa takime në praninë e tri partnerëve gjatë periudhës së partneritetit.

Palët caktojnë një pikë kontakti për kohëzgjatjen e MM:

Për PLAY: Abide Ujkani, Koordinatore e lartë
Për DKRS: Bekim Zaskoku, Zyrtari për Rini
Për DKA: Teuta Berisha, Zyrtare për Arsim

NENI 6: KOHËZGJATJA E MM

Kjo MM hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zgjat përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të projektit S4R. Me marrëveshje me shkrim të të dyja palëve, MM mund të rinovohet.

NENI 7: ANULIMI I MM

Kjo Marrëveshje e Partneritetit mund të ndërpritet në rast të mosmarrëveshjeve të rënda ose mosrespektimit të kushteve të marrëveshjes, nëpërmjet një letre njoftimi.

*Asnjë nga dispozitat e këtij MM nuk kufizon të drejtën e PLAY për të ndaluar, shtyrë ose kufizuar aktivitetet e projektit në rastet e mëposhtme: vendimi i marrë nga donatorët, mungesa e fondeve, çështjet e sigurisë.

NENI 8: VERSIONET GJUHËSORE

Ky MM është hartuar në versionet shqip dhe anglisht, me tri kopje të çdo versioni. Në rast të ndonjë keqkuptimi në interpretimin e kushteve të këtij MM, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

NËNSHKRIMET

Të gjitha palët me këtë rast deklarojnë se kuptojnë dhe bien dakord mbi kushtet e këtij MM, dhe e nënshkruajnë atë me autorizim të plotë.

Vendi: Lipjan

Data: 28/08/2023

Për:
PLAY
International

Bérangère Dailly
Shefe e Misionit



Për:
Departamenti i
Kulturës,
Rinisë dhe
Sportit

Anila Reqica-Llugiqi
Drejtoreshë



Për:
Departamenti i
Arsimit

Rasim Hasani
Drejtor



Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA KOSOVO
OPštINA LIPLJAN

Pranuar me: Priljeno:	06.12.2023	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-352/07-66975		



قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

Memorandum Bashkëpunimi

مذكرة التعاون

Për hapjen e puseve për ujë të pijes

تحفر الآبار للمياه الصالحة للشرب

<p>Pala e pare: Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z.Esam Dabab në cilësinë e drejtorit, tutje referuar si pala e parë, dhe:</p>	<p>الطرف الأول: جمعية قطر الخيرية، مكتب كوسوفا، العنوان في بريشتينا - ويمثلها السيد / عصام ضباب - بصفته مدير المكتب ، ويشار إليها فيما بعد بـ ("الجمعية") و/أو ("الطرف لأول").</p>
<p>Pala e dytë: Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti, tutje referuar si pala e dytë,</p>	<p>الطرف الثاني: بلدية لبيان، ممثلة من قبل الرئيس إمري أحمدى، المشار إليه فيما يلي "الطرف الثاني"</p>
<p>Ato të dyja quhen veçmas si "Palë" dhe kolektivisht si "Palë" ose "Palë".</p>	<p>يشار إلى كلاهما منفصلين "طرف" ومجمعين بـ "الطرفين" أو "الطرفان".</p>
<p>Neni 1: Objekti i Memorandumit Objekt i këtij Memorandumit të Bashkëpunimit është hapja e puseve për ujë të pijes, në vende të ndryshme publike për familjet në kushte të rënda ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit</p>	<p>المادة 1: موضوع المذكرة إن موضوع هذه المذكرة هو حفر الآبار للمياه الصالحة للشرب في الأماكن المختلفة العامة التابعة للعائلات ذوي الاحتياجات الاقتصادية الصعبة في منطقة بلدية لبيان</p>
<p>Neni 2: Obligimet e palës së parë 1.Pala e parë Organizata Qatar Charity merr përsipër: 1. mbulimin e 90% të vlerës së Projektit në emër të shpenzimit direkt për vlerën totale të realizimit të këtij projekti 2. Përzgjedhjen e kompanive për realizimin e projektit; 3. Kontraktimin me kompanitë realizuese dhe përfutuese të granteve.</p>	<p>المادة 2: التزامات الطرف الأول 1. إن الطرف الأول جمعية قطر الخيرية تتحمل مسؤولية: 1. أ. تسديد 90% من المبلغ باسم المصاريف المباشرة من إجمالي المبلغ المطلوب لإنجاز هذا المشروع. 2. اختيار الشركات لإنجاز المشروع. 3. عقد الاتفاقيات مع الشركات المنفذة ومع المستفيدين من المشروع.</p>
<p>Neni 3: Obligimet e palës së dytë 1. Pala e dytë, participon me pjesën prej 10% nga vlera e shpenzimit direkt (financimit të palës së parë), të cilat shfrytëzohen për shpenzime administrative dhe teknike të këtij projekti. 2. Pala e dytë detyrohet që brenda (2) javëve pas rezulttit të komisionit për përzgjedhjen e aplikuesëve si: numri i puseve, lloji, vlera e tyre etj. Këto mjete t'i transferojë në xhirollogarinë e organizatës "Qatar Charity", në Bankën NLB dhe numrin e llogarisë 1701001600054596. 3. Pala e dytë, obligohet që participimin ta dëshmojë me anë të fletëdëshmisë së transferimit të këtyre mjeteve, brenda afatit të lartcekur në paragrafin 2 të këtij Neni. 4. Pala e dytë, duhet te sigurojë mjetin transportues për realizimin e vizitave.</p>	<p>المادة 3: إلتزامات الطرف الثاني 1. يساهم الطرف الثاني بنسبة 10% من إجمالي المصاريف المباشرة (تمويل الطرف الأول)، التي تستعمل للمصاريف الإدارية والتقنية التابعة للمشروع. 2. يلزم الطرف الثاني في غضون أسبوعين بعد استلام تقرير اللجنة المكلفة باختيار المستفيدين وتحديد عدد الآبار وأنواعها وقيمتها.. الخ، ويتم تحويل المبلغ إلى حساب مصرف جمعية "قطر الخيرية" في بنك NLB على الرقم: 1701001600054596 3. يلزم الطرف الثاني أن يثبت مشاركته المقررة بالأوراق المثبتة على تحويل هذا المبلغ ضمن الفترة المذكورة في الفقرة 2 من هذه المادة. 4. يلزم الطرف الثاني أن يوفر وسائل المواصلات للقيام بالزيارات.</p>

no [Signature]

[Signature]



<p>5. Pala e dytë, ka për obligim dërgimin e listës së aplikuesve për bunare dhe listës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente për secilin rast të propozuar, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopja e letërnjoftimit; • Certifikatën nga Gjykata Themelore përkatëse, që tregon se ndaj tij/saj nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale; • Konfirmimin e të ardhurave (pasqyra bankare për periudhën kohore 6 muaj të fundit dhe/ose dokument zyrtar nga ana e institucioneve të vendit i cili vërteton se personi në fjalë është i pa-punë). 	<p>5. يلزم الطرف الثاني بإرسال قائمة مقدمي الطلب لفتح الآبار. يجب أن يلحق بهذه القائمة الأوراق التالية لكل حالة مقترحة، مثل:</p> <ul style="list-style-type: none"> • نسخة عن الهوية الشخصية • شهادة من قبل المحكمة الابتدائية التي تشهد بأن القائم بالطلب غير مطلوب في أي قضية جنائية قيد أسري • بيان الدخل الشهري (كشف حساب بنكي لآخر 6 أشهر و/أو وثيقة رسمية من مؤسسات الدولة تثبت أن الشخص المعني عاطل عن العمل).
<p>Neni 4: Obligimet e ndërsjella</p> <p>Kontaktet mes dy palëve dhe procedurat deri në kohën e nënshkrimit të këtij memorandumit konsiderohen plotësuese të të njëjtit. Procedurat e realizuara janë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Caktimi i personave kontaktues dhe të autorizuar për zhvillimin e procedurave të nevojshme; • Vizitat e të propozuarve prej të dyja palëve (përfaqësuesi i organizatës dhe përfaqësuesit e Komunës); • Përzgjedhja e përfituesve në pajtim me Rregulloren e "QATAR CHARITY" me të cilën përcaktohen kushtet për përzgjedhjen e përfituesve si dhe në koordinim me Komunën; dhe • Në rast të dështimit të hapjes së ndonjë pusi, projekti vazhdon me rastet të cilat janë në listën rezervë të pritjes duke filluar nga ato me numër më të madh të pikëve. Në rast të mos ekzistimit të rasteve nga lista rezervë, palët pajtohen që të vazhdojnë zbatimin e projektit vetëm për numrin e mundshëm të realizuar. 	<p>المادة 4: التزامات الطرفين</p> <p>الإجراءات والتواصل الرسمي حتى موعد تنفيذ المشروع تعتبر من مكملات هذه المذكورة. الإجراءات تكون كالتالي:</p> <ul style="list-style-type: none"> • تعيين جهات الاتصال والأشخاص المخولين لتطوير الإجراءات اللازمة; • زيارة المرشحين يتم من قبل الطرفين (ممثلي الجمعية وممثل البلدية). • اختيار الفائزين يتم من قبل الطرفين وفقا لنظام "قطر الخيرية" التي يتم من خلالها تحديد شروط اختيار الفائزين وكذلك بالتنسيق مع البلدية. • في حالة فشل فتح بئر من الآبار، يستمر المشروع بالحالات الموجودة في قائمة الانتظار الاحتياطية، بدءاً من تلك التي لديها أكبر عدد من النقاط. في حالة عدم وجود حالات من قائمة الاحتياطيات، يتفق الطرفان على الاستمرار في تنفيذ المشروع فقط للعدد المحتمل للتحقيق.
<p>Neni 5: Afati i përmbushjes</p> <p>Palët nënshkruese pajtohen që pranimit teknik të realizohet prej dy palëve dhe finalizimi i projektit do të bëhet brenda një (1) viti.</p>	<p>المادة 5 مدة الإنجاز</p> <p>إن طرفا التوقيع اتفقا على أن القبول التقني سوف يتم من قبل الطرفان الموقعان، وسيتم الانتهاء من المشروع في غضون سنة واحدة.</p>
<p>Neni 6: Të drejtat e ndërsjella</p> <p>Të dy palët mbajnë të drejtën e inspektimit-vizitës pa paralajmërim të përfituesit, fotografimin apo zhvillimin e intervistës me përfituesin, me qëllim që të binden për arritjen e qëllimit të projektit.</p>	<p>المادة 6: الحقوق المتبادلة</p> <p>يحق للطرفين التدقيق والزيارة دون اعلان مسبق للمستفيد وكذلك التصوير أو اجراء مقابلة مع المستفيد بقصد التأكد بأن المشروع قد تحقق حسب المتطلبات.</p>



Komuna e Lipjanit



قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

<p>Neni 7: Ndërprerja dhe amendamenti</p> <p>1. Palët pajtohen që ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndërpritet vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim.</p> <p>2. Palët rezervojnë të drejtën për të ndryshuar ose modifikuar këtë Memorandum me marrëveshje të përbashkët me shkrim, duke marrë parasysh interesat më të mira të projektit dhe palëve të përfshira.</p>	<p>المادة 7 : الإنهاء والتعديل</p> <p>1. يتفق الطرفان على أنه لا يجوز إنهاء مذكرة التعاون هذه إلا باتفاق كتابي متبادل.</p> <p>2. يحتفظ الطرفان بالحق في تغيير أو تعديل هذه المذكرة بموجب اتفاق كتابي متبادل، مع مراعاة المصالح للمشروع والأطراف المعنية.</p>
<p>Neni 8: Forca madhore</p> <p>1. Asnjëra palë nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë dështim ose vonesë në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas këtij Memorandumi nëse dështimi ose vonesa e tillë është për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, duke përfshirë por pa u kufizuar në fatkeqësitë natyrore, veprimet e luftës ose rregulloret qeveritare.</p> <p>2. Pala e prekur duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër për ekzistimin e një ngjarjeje të forcës madhore dhe të marrë masa të arsyeshme për të minimizuar ndikimin e një ngjarjeje të tillë në projekt.</p>	<p>المادة 8 : القوة القاهرة</p> <p>1. لن يكون أي من الطرفين مسؤولاً عن أي فشل أو تأخير في أداء التزاماته بموجب هذه المذكرة إذا كان هذا الفشل أو التأخير بسبب أحداث القوة القاهرة، بما في ذلك على سبيل المثال لا الحصر الكوارث الطبيعية أو أعمال الحرب أو اللوائح الحكومية.</p> <p>2. يجب على الطرف المتضرر إخطار الطرف الآخر على الفور بوجود حدث قوة القاهرة واتخاذ التدابير المعقولة لتقليل تأثير مثل هذا الحدث على المشروع.</p>
<p>Neni 9: Publiciteti dhe komunikimi</p> <p>1. Palët bien dakord të zhvillojnë së bashku një plan komunikimi për të promovuar dhe rritur ndërgjegjësimin për projektin dhe rezultatet e tij.</p> <p>2. Çdo deklaratë publike ose njoftim për shtyp në lidhje me Projektin duhet të koordinohet dhe miratohet paraprakisht nga të dyja palët.</p>	<p>المادة 9: الدعاية والاتصال</p> <p>1. يتفق الطرفان على وضع خطة اتصال مشتركة لتعزيز ورفع مستوى الوعي بالمشروع ونتائجه.</p> <p>2. يجب تنسيق أي بيان عام أو بيان صحفي يتعلق بالمشروع والموافقة عليه مسبقاً من قبل الطرفين.</p>
<p>Neni 10: Të përgjithshme</p> <p>Rregullat e përgjithshme që Rregullojnë bashkëpunimin e Qatar Charity me të gjitha palët gjatë zbatimit të projekteve të saj, janë:</p> <p>i. Respektimi i të drejtave të fëmijës, mbrojtja e grupeve të marginalizuara dhe parandalimi i shkeljes së të drejtave të tyre;</p> <p>ii. Respektimi i parimit të transparencës dhe rregullave të anti-korrupsionit dhe nepotizmit;</p> <p>iii. Respektimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare;</p> <p>iv. Ndërprerja e çdo marrëdhënieje kontraktuale më palën kontraktuese, nëse mëson drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë (nëpërmjet bazës së të dhënave World Check) se kontraktuesi është dënuar më parë për një vepër penale, apo se është akuzuar për pastrim të parave apo financim të terrorizmit, në përputhje me ligjet në fuqi;</p> <p>v. Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me ndalimin e pastrimit të parave dhe ndalimin e financimit të terrorizmit.</p>	<p>المادة 10 : عامة</p> <p>القواعد العامة التي تنظم تعاون قطر الخيرية مع جميع الأطراف أثناء تنفيذ المشاريع، هي:</p> <p>i. مراعاة حقوق الأطفال، حماية الفئات المهمشة وعدم السماح لأي طرف استغلالهم أو انتهاك حقوقهم</p> <p>ii. مراعاة مبدأ الشفافية وأنظمة مكافحة الفساد ومحاكاة الأقارب؛</p> <p>iii. احترام الأنظمة المتعلقة بالعناية بالبيئة وفقاً للقوانين والأنظمة الدولية؛</p> <p>iv. إنهاء جميع العلاقات التعاقدية مع الأطراف المتعاقدة، إذا علم بأي شكل من الأشكال (بما في ذلك المعلومات التي تم الحصول عليها من قاعدة بيانات التحقق العالمية) أن المقاول قد أدين سابقاً بارتكاب جريمة جنائية، أو تم اتهامه بغسل الأموال، أو تمويل الإرهاب، وفقاً للقوانين المعمول بها</p> <p>v. احترام القانون والأنظمة المتعلقة بحظر غسيل الأموال، أو حظر تمويل الإرهاب.</p>

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]




Komuna e Lipjanit



قطر الخيرية
QATAR CHARITY
Kosovo

<p>Neni 11: Ligj i aplikueshëm dhe zgjidhja e konflikteve</p> <p>Ky Memorandum rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Memorandum, duke përfshirë këtu edhe mosmarrëveshjet për sa i përket ekzistencës, vlefshmërisë, shkeljes ose përfundimit të saj do të zgjidhet në mënyrë miqësore dhe me mirëbesim me anë të negociatave dhe diskutimeve mes palëve. Mosmarrëveshjet të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda tridhjetë (30) ditësh, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente në Kosovë.</p>	<p>المادة 11: القانون المعمول به وحل الاشكاليات</p> <p>تخضع هذه المذكرة وتفسر وفقاً للقوانين المعمول بها في جمهورية كوسوفا. أي نزاع يتعلق بهذه المذكرة، بما في ذلك النزاعات المتعلقة بوجودها أو صحتها أو خرقها أو إختصاصها، يتم حله ودياً وبحسن نية من خلال المفاوضات والمناقشات بين الطرفين. سيتم حل النزاعات التي لا يمكن حلها ودياً خلال ثلاثين (30) يوماً من قبل المحكمة المختصة في كوسوفا.</p>
<p>Neni 12</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ky memorandum është përpiluar dhe nënshkruar në dy (2) kopje identike, prej të cilëve secila palë mban nga një (1) kopje 2. Në rast të mospërputhjes së teksteve, teksti në gjuhën shqipe do të konsiderohet tekst bazë. 	<p>المادة 12:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 تم تحرير وتوقيع هذه المذكرة في نسختين أصليتين، لكل طرف نسخة واحدة. 2 في حال وجود أي تعارض أو خلاف بين محتوى النصين يعتبر النص باللغة اللبانية هو النص الاساسي الذي يرجع اليه.
<p>Nënshkruar nga dhe për Organizatën Qatar Charity Drejtori i Organizatës Qatar Charity – zyra në Kosovë Esam Dabab</p> <p>Nënshkruar nga dhe për Komunën e Lipjanit Kryetar i Komunes se Lipjanit Imri Ahmeti</p>	<p>وقع من قبل وعن جمعية قطر الخيرية مدير مكتب قطر الخيرية – مكتب كوسوفا عصام ضباب</p> <p>وقع من قبل وعن بلدية لبيان رئيس بلدية لبيان إمري أحمددي</p>
<p>Nënshkrimi / التوقيع</p>   <p>Data: 06.12.2023</p>	<p>Nënshkrimi / التوقيع</p>   <p>التاريخ: 06.12.2023</p>



Pranuar me:
Priljeno: 05.07.2023

Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
	1-400/01-34396	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 2023

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Ligji Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, lidhet kjo:

MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROJEKTIT "RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN MEDVEC" KOMUNA E LIPJANIT

Ndërmjet:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e përfaqësuar nga Ministri i MAPL-së (në tekstin e mëtejme MAPL),

dhe,

2. Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga Kryetari Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 1 Qëllimi

Marrëveshja parasheh të drejtat dhe detyrimet e palëve në respektimin e rregullave të përcaktuara për bashkëfinancim/ financim të projektit, afatet dhe kushtet e tjera për subjektet juridike, me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të buxhetit të ofruar nga MAPL.

Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

1.Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëfinancimin/ financimin e projektit si në vijim:

Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Medvec.

Neni 3 Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit/financimit

- 1.Shuma totale e projektit në vlerën paralogaritare është 80,890.00 €.
- 2.Shuma totale e ndare nga buxheti i MAPL -së për vitin 2023, është 50,000.00 €.
- 3.Shuma totale e ndare nga buxheti i komunës për vitin 2023, është 30,890.00 €.
- 4.Çdo vlerë që e kalon vlerën paralogaritare të projektit financohet nga buxheti i komunës.

Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e MAPL-së

1. MAPL-ja i zotën mjetet për projektin nga neni 3 paragrafi 2. të kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
- 2.Pagesat nga MAPL, për vlerën e bashkëfinancimit/financimit do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve/ furnizimeve sipas kushteve të kontratës.
- 3.MAPL përmes monitoruesit është në kontakt të vazhdueshëm me komunën për këtë projekt dhe në rast se vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës/projektit njofton menaxhmentin e MAPL-së.
4. MAPL nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërliken me autorizimet e saja, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit/ implementimit të projekteve që bie në përgjegjësi të komunës.

Neni 5 Të drejtat dhe detyrimet e Komunës

1. Komuna ka të drejtën e bashkëfinancimit të projektit sipas nenit 3 të kësaj marrëveshjeje.
- 2.Komuna obligohet të zhvillojë procedurat e prokurimit për implementimin e projektit në përputhje me këtë marrëveshje sipas legjislacionit në fuqi.

3. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE), të sjellë në MAPL një kopje të kontratës dhe ofertën financiare identike me origjinalin, së bashku me informatat për biznesin me qëllim të nxjerrjes së urdhër blerjes, si vijon:

- certifikatën për regjistrimin e biznesit - ARBK;
- vërtetimi i llogarisë bankare;
- kopjen e dokumentit identifikues të pronarit të biznesit.

4. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve dhe komisionin i cili lëshon certifikatën e pranimit të punimeve/pranimin teknik.

5. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë, vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera, në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar (faturën), me kërkesën për realizimin e pagesës të punimeve/furnizimeve të kryera, duke iu referuar kushteve të kontratës.

6. Komuna obligohet që të njoftojë MAPL-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit.

7. Komuna obligohet të informojë MAPL-në për dinamikën e punimeve deri në përfundim të projektit.

8. Situatat e para për punët e kryera dërgohen në MAPL.

8. Komuna obligohet që para inaugurimit të projektit të njoftojë MAPL dhe të dërgojë ftesën për pjesëmarrje.

9. Komuna obligohet të vendosë tabelën informuese (panon) në vend ndërtim me të gjitha informatat e nevojshme.

Neni 6

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Komuna obligohet që për realizimin e pagesave për punët/furnizimet e kryera të komplettoj dokumentacionin si në vijim:

1.1. Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare e cila duhet të jetë identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës.

1.2. Vendimin për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e Komunës, në rast se nuk është e definuar me kushtet e veçanta në kontratë.

1.3. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës, komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera të aprovuara (origjinali).

1.4. Faturën nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar (origjinali).

1.5. Sigurimin e ekzekutimit, garancionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës.

Neni 7
Afati i realizimit të projektit

1. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti për mjetet e MAPL-ës duhet të përfundojë brenda vitit buxhetor 2023.
2. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha obligimet /detyrimet i bartë Komuna.

Neni 8
Pronësia e projektit

1. Pas pranimit teknik të projektit, komuna është e obliguar që një kopje të pranimit teknik ta dërgoj në MAPL, me qëllim që projekti i financuar sipas kësaj marrëveshje do të transferohet në pronësi të Komunës.
2. Komuna është e detyruar të regjistrojë projektet nën pronësi të saj brenda sistemit të aseteve të Ministrisë së Financave (SIMFK).
3. Projekti kalon në pronësi të komunës në rastin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit: pagesën e fundit me pranim teknik; kur MAPL i kryen të gjitha pagesat e situacioneve; dhe në rastet e bashkëfinancimit kur komuna e kryen pagesën - situacionin e fundit me pranim teknik. Me këtë rast, MAPL mbyll llogarinë e investimeve, ndërsa Komuna, pasurinë jo financiare të pranuar nga MAPL e regjistron në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

Neni 9
Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së financimit

1. Marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet me pëlqim paraprak të MAPL-së dhe Komunës.
2. MAPL mbajnë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se Komuna nuk i përmbahet kushteve të kësaj marrëveshje.


Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet e mundshme të zgjidhen me mirëkuptim.



Neni 11
Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL dhe Komuna.
2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në gjuhën shqipe dhe serbe dhe nga dy (2) kopje autentike, një për secilën nga palët nënshkruese.

Elbert Krasniqi
Ministër i MAPL-së



Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës së Lipjanit






KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVOS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLICA OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Pranuar me: Primljeno:	23.10.2023	
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
01-352/03-60462		



KOMPANIA UJESJELLESË RAJONALE SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.
PRISHTINA

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur në Lipjan me datë 16.10 2023, ndërmjet:

Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe

Kompanisë Rajonale të Ujësjetllësit "Prishtina" Sh.A., rr. "Hazir Shala" nr.4, përfaqësuar nga Kryeshëfi Ekzekutiv z. Arsim Fetahu (në vazhdim të tekstit: Kompania)

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj Marrëveshje të Mirëkuptimit është realizimi i punimeve "Rehabilitimi i Gropave" me Komunën e Lipjanit.

Neni 2 Obligimet e Komunës

1. Komuna me anë të kësaj Marrëveshje, merr obligim që të realizojë procedurat e prokurimit dhe kryerjen e punimeve përmes Kontraktorit të përzgjedhur nga ana e saj për këtë projekt.
2. Komuna do të faturojë punët e mbushjes së gropave dhe riasfaltimin, kthimin në gjendjen e mëparshme me rastin e kryerjes së punimeve nga kompania e ujësjetllësit në rrugët komunale pas pranimit të punimeve të kryera nga kompania për mirëmbajtje të rrugëve.
3. Komuna dhe Kompania e në rrugët komunale emërojnë menaxherët në zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
4. Komuna e Lipjanit jep pëlqim paraprak për fillimin e punimeve në rrugë komunale.

Neni 3

Obligimet e Kompanisë

1. Me anë të kësaj Marrëveshje, Kompania merr obligim që të financojë punimet e kryera në kuadër të projektit "Rehabilitimi i Gropave".
2. Kompania është e obliguar që në afat prej 30 ditëve kalendarike të paguaj faturat e dërguara nga Komuna përkitazi me pikën 2 të nenit 2 të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.
3. Kompania e ujesjellësit obligohet paraprakisht të paiset me pëlqim nga Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në Lipjan për fillimin e punimeve në rruget komunale ne te cilat ka nevojë te sanohen defektet e ujesjellesit dhe kanalizimit.
4. Kompania dhe Komuna në rrugët komunale emërojnë menaxherët në zbatimin e kësaj marrëveshjeje .

Neni 4

Zhvillimi i procedurave të prokurimit

1. Procedurat e prokurimit do të zhvillohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, të cilat do të udhëhiqen nga Komuna.
2. Disbursimi i mjeteve nga Kompania do të realizohet direkt tek Kontraktori pas pranimit të situacioneve të kryerjes së punimeve të aprovuara nga Mbikëqyrësi i Projektit.

Neni 5

Mbikëqyrja e punimeve

Mbikëqyrja e kontratës do të kryhet nga të dy palët e këtij Marrëveshje, ku secili do të caktojë nga një person për mbikëqyrje të punimeve

Neni 6

Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim nga të dy palët.
2. Në rast të çfarëdo paqartësie (kontesti) të kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit, secila palë obligohet të njoftoj palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën me të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga kjo Marrëveshje Bashkëpunimi. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, atëherë pala mundë të adresojë çështjen në gjykatën kompetente.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët .
2. Kjo Marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

z. Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit



z. Arsim Fetahu

Kryeshf Ekzekutiv i i KRU "Prishtina" sh.a

